



# PUNA E KUVENDIT TË KOSOVËS GJATË VITIT 2023

Dhjetor, 2023







Instituti Demokratik i Kosovës është degë e  
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e  
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse  
dhe luftës kundër korrupsion përmes  
promovimit të transparencës,  
llogaridhënies dhe integritetit në të  
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

COPYRIGHT © 2023. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Autorë: **Arbër Thaçi**

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 239,  
10 000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +383 (0) 38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Ueb: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)



Kingdom of the Netherlands

Layout and design: **envinion**

Ky raport është rezultat i një hulumtimi që është realizuar në kuadër të projektit “Zgjerimi i hapësirës qytetare për reformën në drejtësi”, i financuar nga Ambasada Holandeze në Prishtinë. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Ambasadës Holandeze në Prishtinë.

# TABELA E PËRMBAJTJES

## HYRJE - 6

1. Realizimi i Agjendës Legjislative - 7
  2. Ushtrimi i rolit mbikëqyrës ndaj Ekzekutivit - 10
  3. Rregullorja dhe normalizimi i precedenteve mosrespektuese - 14
  4. Sjellja e Deputetëve dhe Mungesat në punimet e Kuvendit - 17
  5. Trajtimi i legjislacionit për Reformën në Drejtësi - 20
  6. Transparenca ndaj publikut - 23
  7. Puna e Komisioneve Parlamentare - 26
- PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME - 32



# HYRJJE

Ky raport analitik vlerëson punën e Kuvendit të Kosovës gjatë vitit 2023, nga fillimi i sesionit pranveror me 16 janar deri në përfundim të sesionit vjeshtor me 22 dhjetor.

Raporti është rezultat i monitorimit sistematik të Kuvendit, nga ana e KDI-së, përmes monitorimit fizik dhe elektronik të punimeve të Kuvendit, të seancave, komisioneve dhe aktiviteteve tjera të zhvilluara në Kuvend.

Pjesa e parë e raportit pasqyron zhvillimet në seanca të Kuvendit. Kjo pjesë e ndarë në shpjegime mbi procesin ligjvënës, mbikëqyrjen ndaj Ekzekutivit, çështjen e zbatimit të Rregullores dhe transparencën e Kuvendit ndaj publikut, hedh dritë në mënyrë të detajshme mbi punën parlamentare gjatë vitit 2023.

Në pjesën e dytë të raportit është e paraqitur puna e komisioneve, përmes ofrimit të të dhënave kuantitative apo kualitative. Së bashku me paraqitjen e numrave që njehsojnë aktivitetin këtyre komisioneve, brenda përshkrimeve ofrohen edhe cilësime për segmentet ku komisionet performuan mirë, si dhe kritika për mangësitë ku ato duhet të synojnë të përmirësohen.

Po ashtu, raporti përfshin edhe një seksion të veçantë që në mënyrë përshkruese, përmbledhë rolin e Kuvendit në drejtim të reformimit të sistemit të drejtësisë. Më saktësisht, subjekte nëpërmjet të cilave zhvillohet trajtimi janë identifikimi i materialit legjislativ të trajtuar nga Kuvendi, edhe në kuptimin sasior të numrimit të tyre, por edhe në kuptimin përmbajtësor të diskutimit mbi procesin e trajtimit dhe çështje të ndërlidhura.

Për fund, raporti, në formë deduktive harton përfundime dhe ofron rekomandime për Kuvendin dhe deputetët, në atë mënyrë që mangësitë që janë shpërfaqur qartazi këtë vit edhe jo vetëm] të mos përsëriten në të ardhmen.



# 1. Realizimi i Agjendës Legjislative

Funksioni legjislativ i Kuvendit paraqet funksionin parësor për nga rëndësia. Në këtë aktivitet, Kuvendi i Kosovës edhe gjatë vitit 2023 ka shfaqur mangësitë e zakonshme – pa dallime përmbajtësore mes dy sesioneve parlamentare. Në praktika të normalizuara, Kuvendi ka organizuar veprimtarinë në agjenda të ngarkuara brenda periudhave të shkurta. Derisa, pothuajse në tërësi materiali legjislativ vazhdon të hartohet nga ekzekutivi. **Rendet e ditës të ngarkuara, të shpërndara në pak seanca dhe mungesa e një roli të drejtpërdrejt në ligjbërje, paraqesin problemet kryesore, në rubrikën e funksionit legjislativ të Kuvendit.**

Gjatë vitit 2023 janë mbajtur gjithsej 78 seanca, nga të cilat 36 ishin seanca plenare, 27 vazhdime të seancave, 13 të jashtëzakonshme dhe 2 seanca solemne.<sup>1</sup> Mungesa e planifikimeve paraprake vërehet tek raporti i numrit të seancave plenare me vazhdimet e seancave – çdo seancë në Kuvend, ka shkaktuar së paku edhe një vazhdim të seancës. Derisa, ngarkesa e agjendës legjislative dëmton trajtimin adekuat të materialit legjislativ në Kuvend – diskutimi sipërfaqësor që rezulton me votim nuk shterohet, në mënyrë që vendimmarrja të jetë e mbështetur në argumentim mbi përmbajtjen e projektligjeve. Pothuajse në të gjitha rastet projektligjet që propozohen nga Qeveria pësojnë vetëm ndryshime minimale gjatë shqyrtimit në Kuvend.

**Tabela 1.1: Numri i Seancave të mbajtura gjatë vitit 2023**

SEANCA	Sesioni pranveror	Sesioni vjeshtor	Gjithsej në vitin 2023
Plenare	22	14	36
Vazhdime	17	10	27
Të Jashtëzakonshme	8	5	13
Solemne	2	0	2
<b>GJITHSEJ</b>	<b>49</b>	<b>29</b>	<b>78</b>

Përveç numrit të madh të vazhdimet të seancave të mbajtura në kohë të ngushtë, rëndom votimi i materialit legjislativ është zgjatur në disa javë apo muaj nga momenti i trajtimit në seancë parlamentare, fenomen ky që paraqet problem serioz në cilësinë e shqyrtimit. Një praktikë si kjo, megjithëqë është kritikuar mjaft arsyeshëm, nuk e ka vënë në lëvizje Kuvendin për të ndërmarrë ndonjë veprim në drejtim të përmirësimit të saj. Rendet e ditës duhet të planifikohen në mënyrë shumë më racionale, në mënyrë që deputetët të mund të ofrojnë trajtimin e merituar çdonjërës pikë dhe periudha nga trajtimi në votim të jetë sa më e ngushtë – çdoherë me synimin e ideale, që të dy këto, edhe trajtimi edhe votimi, të ndodhin brenda

<sup>1</sup> Të dhënat janë të qasshme në ueb-faqën e Kuvendit, tek rubrika e "Seancave", në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/seancat/seancat/>



Gjatë vitit 2023 janë mbajtur gjithsej **78 seanca**, nga të cilat **36** ishin seanca plenare, **27** vazhdimet e seancave, **13** të jashtëzakonshme dhe **2** seanca solemne. Mungesa e planifikimeve paraprake vërehet tek raporti i numrit të seancave plenare me vazhdimet e seancave – çdo seancë në Kuvend, ka shkaktuar së paku edhe një vazhdim të seancës.

të njëjtës ditë. Zgjidhje në raport me këtë do të ishte rritja e numrit të seancave, të cilat duhet të planifikohen në rende dite të arritshme për tu trajtuar dhe të shtrihen më mirë gjatë ditëve të punës së Kuvendit. Lidhur me këtë Kuvendi sa më parë duhet të fillojë praktikën e krijimit të kalendarit mujor, i cili do të mundësonte planifikim më të mirëfilltë të punës së Kuvendit.

**Ngjashëm, për tu kritikuar vazhdon të jetë roli pasiv i Kuvendit në procesin e hartimit të ligjeve. Kuvendi dhe deputetët penalizohen nga fakti që në procesin e hartimit të materialit legjislativ nuk bashkangjiten si aktorë ligjbërës, por vetëm si ligjvënës.** Deri në këtë fazë, Kuvendi nuk ka luajtur rolin e organit ligjbërës, meqë projektligjet e trajtuara në Kuvend, hartohen paraprakisht nga ekzekutivi. Kështu, Kuvendi shërben si një organ trajtimi të materialeve të ardhura nga ekzekutivi – raport ky që duhet të ndryshohet, me Kuvendin që duhet të bartë më tepër përgjegjësi në pikëpamje të funksionit legjislativ, duke marrur pjesë drejtpërdrejt në procesin e ligjbërjes dhe jo vetëm shqyrtimin e tyre.

Tek realizimi i planifikimeve legjislative, mund të pohohet se Kuvendi nuk qëndroi aspak mirë gjatë këtij sesioni vjeshtor dhe vitit 2023 në përgjithësi. Në këtë përfundim, përgjegjësia bie pjesë më mbi Kuvendin si organ për trajtimin legjislativ të materialit dhe pjesë më mbi ekzekutivin, për pamundësinë e përmbushjes së pritshmërive të publikuara në Programin Legjislativ për vitin 2023.<sup>2</sup> **Përgjatë vitit të plotë të punës parlamentare, Kuvendi ka miratuar 71 projektligje mes tyre 16 marrëveshje ndërkombëtare, që prekin fushë të gjerë veprimi, ndërsa vetëm 29 nga këto projektligje janë pjesë e agjendës legjislative të vitit 2023. Shprehur në përqindje, Kuvendi ka miratuar vetëm 25% të agjendës legjislative të vitit 2023. Ndërsa, 42 projektligje të miratuara janë pjesë e agjendave të viteve 2022 dhe 2021.**<sup>3</sup>

Puna e kësaj legjislature përgjatë këtij viti, nuk kufizohet vetëm në projektligjet e miratuara, meqenëqë një numër i konsiderueshëm i tyre janë në shqyrtim. Më saktësisht, **45 projektligje, kanë mbetur ende në procedura shqyrtuese brenda Kuvendit, të cilët janë pjesë e agjendës legjislative 2023 dhe agjendave të viteve të kaluara. Mes tyre, në pritje për miratim janë edhe 8 marrëveshje ndërkombëtare. Duhet të përkohet fakti se 55 projektligje apo 48% e Programit Legjislativ të Qeverisë të vitit 2023, nuk është dërguar fare në Kuvend.**

Në kuptim të përgjegjësisë që bie mbi deputetët, në funksionin e përditshëm ata do të duhej të bënin më shumë në trajtimin e materialit legjislativ që ka buruar nga agjenda legjislative. Nga këndvështrimi i realizimit të agjendës legjislative 2023, miratimi i vetëm 29 projektligjeve dhe mbetja në procedurë e 30 projektligjeve tjera nga kjo agjendë, e të Kuvendin larg përmbushjes së agjendës legjislative të vitit 2023.

Debati mbi përgjegjshmërinë e deputetëve kundrejt obligimeve dhe detyrave që burojnë nga funksioni i tyre, duhet të zgjerohet edhe tek qasja joadekuate kundrejt marrëveshjeve ndërkombëtare. **Ligjvënësit, për muaj më radhë, refuzuan**

2 Programi Legjislativ Qeverisë 2023, i qasshëm në ueb-faqën e Zyrës së Kryeministrit, në vegëzën: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/11/Programi-Legjislativ-per-vitin-2023-9.11.2023.pdf>

3 Shih Dokumentin e "Evidencës së Ligjeve", i qasshëm në ueb-faqën e Kuvendit, në vegëzën: [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Evidencaelgjeve\\_WRW3rz9hJa.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Evidencaelgjeve_WRW3rz9hJa.pdf)







**45 projektligje**, kanë mbetur ende në procedura shqyrtuese brenda Kuvendit, të cilët janë pjesë e agjendës legjislativë 2023 dhe agjendave të viteve të kaluara. Mes tyre, në pritje për miratim janë edhe **8 marrëveshje** ndërkombëtare. Duhet të pëhtesohet fakti se **55 projektligje** apo **48%** e Programit Legjislativ të Qeverisë të vitit 2023, nuk është dërguar fare në Kuvend.

të trajtojnë marrëveshjet ndërkombëtare, pa ofruar ndonjë arsyetim. Në formën siç duhet të kritikohet botëkuptimi se marrëveshjet kërkojnë apriori votim të domosdoshëm, edhe qasja moskokëçarëse e deputetëve kundrejt trajtimit të këtyre marrëveshjeve duhet të kritikohet. **Çdo marrëveshje ndërkombëtare e sjellë nga ekzekutivi duhet t'i nënshtrohet një debati të mirëfilltë parlamentar dhe të trajtohet në periudha kohore optimale.**

Në pikëpamje krahasimtare, të dhënat shpërfaqin performancën më të ulët që ka treguar Kuvendi – dhe atë në [pothuajse] çdo parametër. Në vitin 2022, Kuvendi kishte zhvilluar afërsisht 100 seanca, kurse këtë vit ka organizuar 78 të tilla. Në një trend të ngjashëm rënieje, Kuvendi kishte miratuar 111 projektligje gjatë vitit 2022, gjersa në vitin 2023 ka miratuar 71 ligje – një pjesë çereku më pak, apo shprehur në numra 36% më pak.<sup>4</sup>

Në formë krejtësisht të ngjashme, puna legjislativë e ekzekutivit nuk përmbushi pritshmëritë e caktuara nga Qeveria në Programin Legjislativ për 2023, meqë ritmi i punës i materialeve legjislativë ishte më i ngadaltë, afërsisht 52% e projektligjeve janë dërguar në Kuvend – fakt ky që qartëson dështimin e Qeverisë në këtë drejtim.

Këtij rendimenti të ulët pune, i ka ndihmuar **mungesa e dialogut normal ndërmjet partive parlamentare.**<sup>5</sup> **Polarizimi mes pozitës dhe opozitës ka shkaktuar vështirësi në realizimin e punës parlamentare, posaçërisht në çështjet që kërkojnë 2/3 e votave siç është rasti tek marrëveshjet ndërkombëtare.** Çarjet politike janë reflektuar në secilin parametër të punës së Kuvendit, duke përkeqësuar qoftë rezultatin e punës apo aspekte tjera sikurse gjuha jo-parlamentare, sjelljet e papërshtatshme të deputetëve, etj.

4 Instituti Demokratik i Kosovës: "PLANIFIKIMI I PUNËS DHE MUNGESAT E DEPUTETËVE MBETEN SFIDË", i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/aktivitetet/kdi-kuvendi-permbushi-69-agjenden-legjislativ-gjate-ketij-viti-planifikimi-i-punes-dhe-mungesat-e-deputeteve-mbeten-sfide/?fbclid=IwAR1AD8x33cQaPRe8pRqxQ1vbi3vnCWKy0cKp94aAFEREpUdLVDGHVnbZ-C0>

5 Raporti i Komisionit Europian 2023, f. 9; i qasshëm në vegëzën: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD\\_2023\\_692%20Kosovo%20report\\_0.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf)





## 2. Ushtrimi i rolit mbikëqyrës ndaj Ekzekutivit

Funksioni mbikëqyrës përfaqëson një prerogativë që mundëson veprimtarinë kontrolluese të pushtetit legjislativ, qoftë kundrejt institucioneve që përfshihen në pushtetin ekzekutiv, por dhe institucioneve tjera publike.<sup>6</sup> Ndonëse mbikëqyrja është instrument esencial në punën parlamentare, Kuvendi nuk ka materializuar mjaftueshëm mbi këtë rol në mënyrë që të fuqizojë anën e tij mbikëqyrëse.<sup>7</sup> **Ushtrimi i këtij funksioni së fundi ka treguar rënie të evidentuar lehtësisht përmes ngjarjeve sikurse vështirësimi i themelimit të punës së Komisionit Hetimor Parlamentar për Rezerva, refuzimi për të dhënë përgjigje pyetje parlamentare të ardhura nga opozita dhe refuzimi për raportim pranë komisionesh nga anëtarët e ekzekutivit.<sup>8</sup>**

Një nga rastet më të shquara të dështimit të funksionit mbikëqyrës të Kuvendit është rasti i Komisionit Hetimor Parlamentar për Rezerva Shtetërore. Në seancën e 20 shtatorit, me votën e 69 deputetëve, Kuvendi themeloi këtë komision hetimor për të trajtuar çështjen e skandalit me rezervat shtetërore.<sup>9</sup> Megjithëse për themelimin e tij vendosi Kuvendi, ai mezi ia doli të funksionalizohej pas 8 tentimeve të deputetëve opozitarë, pasi që deputetët nga radhët e partisë në pushtet bojkotonin mbledhjen konstitutive të këtij komisioni, duke e pamundësuar themelimin e tij.<sup>10</sup> Një rast sikurse ky, paraqet një zhvillim tejet negativ për punën mbikëqyrëse të mekanizmave të Kuvendit, ndërsa klima moskokëçarëse brenda partisë në pushtet kundrejt përkeqësimit të aktivitetit mbikëqyrës të deputetëve të tyre, përbën fenomenin më shqetësues.

Ndërsa, në këtë temë, duhet të kritikohet edhe roli i Drejtorisë për Shërbime Juridike dhe Përafrim të Legjislacionit, e cila duke shmangur pyetjen kryesore të opozitës në lidhje me zëvendësimin e deputeteve anëtarë nga radhët e Vetëvendosjes, ndihmoi në rritjen e paqartësisë së situatës, duke përfunduar në mosfunksionalizimin e mekanizmit hetues me kohë.<sup>11</sup>

**Gjatë sesioni të vjeshtor, Kuvendi është përballur edhe me bllokimin e një prej mekanizmave më të përdorur në mbikëqyrje të ekzekutivit, atë të pyetjeve parlamentare. Kryeministri Kurti, në seancën e 6 tetorit, njoftoi se nuk do të ofrojë përgjigje në pyetjet parlamentare, të parashtuara nga deputetët opozitarë, të cilët nuk po votonin marrëveshjet ndërkombëtare<sup>12</sup> Derisa trajtimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, mbetet të jetë në diskrecionin e deputetit, për të ushtruar vullnetin e lirë të përcaktuar sipas Kushtetutës<sup>13</sup>, ofrimi i përgjigjeve për pyetjet e deputetëve, paraqet obligim ligjor të ekzekutivit kundrejt parlamentarëve. Këto përpjekje kushtëzuese, përveç që kanë dëmtuar funksionin mbikëqyrës të Kuvendit, paraqesin një përpjekje për t'u mbivendosur vullnetit të lirë të deputetit, nga ana ekzekutivit. Kjo ka**

6 Kushtetuta e Kosovës, Neni 65, Paragrafi 9, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

7 Raporti i Komisionit Evropian për Vendiin 2023, 8-9 ; i qasshëm në vegëzën: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD\\_2023\\_692%20Kosovo%20report\\_0.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf)

8 Deklarata e Kryetares së Komisionit për Integritim Evropian, Rrezarta Krasniqi, në Konferencën e KDI-së "Fuqizimi i Kuvendit në Mbikëqyrjen e Zbatimit të Zotimeve të Kosovës, në Procesin e Berlinit", me datën 20/12/2023.

9 Lajmi në uef-faqën e Kuvendit, i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-punimet-e-seanc-es-plenare-33315/>

10 "Komisioni për rezervat shtetërore mban mbledhjen e parë, diskutohet për planin e punës"; Lajmi i qasshëm në platformën Kallxo, në vegëzën: <https://kallxo.com/lajm/komisioni-per-rezervat-shtetere-mban-mbledhjen-e-pare-diskutohet-per-planin-e-punes/>

11 Opinion Ligjor nga Drejtoria për Shërbime Juridike dhe Përafrim të Legjislacionit, 24/10/2023

12 Lajmi në uef-faqën e Kuvendit, i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-punimet-e-seanc-es-plenare-33445/>

13 Kushtetura e Kosovës, Neni 70, Paragrafi 1



|||||

dëmtuar edhe vet rezultatin pozitiv të Kryeministrit Kurti gjatë sesionit pranveror, i cili u ishte përgjigjur të gjitha pyetjeve të deputetëve. Krejt në mënyrë të kundërt, Kryeministri, nuk ofroi asnjë përgjigje për 9 pyetjet parlamentare, duke refuzuar që tu përgjigjet deputetëve nga partitë opozitare.

Kjo qasje bojkotuese e pyetjeve parlamentare ka dhënë rezultatin e saj, ndonëse nuk ndikoi numrin e pyetjeve parlamentare në përgjithësi, zbehu funksionin mbikëqyrës të pyetjes parlamentare. **Në kuptimin numrik të parashtrimit të pyetjeve parlamentare, më së shumti pyetje ndaj ekzekutivit gjatë vitit 2023 ka parashtruar LVV me gjithsej 183 pyetje, pasuar nga PDK me 66 pyetje, AAK me 31 pyetje dhe LDK me më së paku pyetje nga partitë e mëdha, me vetëm 16 pyetje parlamentare.**

Partitë parlamentare renditen kështu me mesatarën për deputet: Vetëvendosje 3,2 pyetje; PDK 3,6; LDK 1; AAK 3,8; Komunitetet si grup parlamentar 0,2 pyetje. Për më tepër detaje, shihni tabelën më poshtë.

**Tabela 1.2: Pyetjet Parlamentare sipas Grupeve Parlamentare<sup>14</sup>**

Subjekti	Sesioni pranveror		Sesioni vjeshtor		Gjithsej për vitin 2023	
	Numri i Pyetjeve	Mesatarja për deputet	Numri i Pyetjeve	Mesatarja për deputet	Numri i Pyetjeve	Mesatarja për deputet
Vetëvendosje	102	1,8	81	1,4	183	3,2
PDK	44	2,4	22	1,2	66	3,6
LDK	10	0,65	6	0,35	16	1
AAK	13	1,6	18	2,2	31	3,8
GRUPI MULTIETNIK	1	0,1	1	0,1	2	0,2
Lista Serbe	0	0	0	0	0	0

Si rezultati i bojkotimit të pyetjeve parlamentare nga ekzekutivi, kanë ndryshuar edhe të dhënat e përgjigjeve ndërmjet sesioneve, me lëvizje drastike. Derisa në sesionin e parë, përgjithshëm mund të vlerësohej se ekzekutivi në masë të konsiderueshme pyetjet parlamentare i kishte trajtuar seriozisht, me përjashtim të ministrave Xhelal Sveçla dhe Donika Gërvalla. Kësisoj, kryeministrit Kurti dhe ministrat e kabinetit të tij u janë shtuar një numër pyetjesh, për të cilat ata refuzuan të përgjigjen. **Ndërsa e pandryshuar mbeti gjendja e ministrit Sveçla, prej një kampioni të papërgjegjshmërisë kundrejt pyetjeve të deputeteve – ai vazhdoi të mos ofrojë asnjë përgjigje, duke plotësuar një vit pa asnjë përgjigje, derisa nuk është qortuar asnjëherë për këtë nga ana e kryekuvendarit, për mospjesëmarrje në seancën e pyetjeve parlamentare, ashtu siç përcakton Rregullorja e punës së Kuvendit.<sup>15</sup> Në formë të ngjashme sikurse Sveçla, edhe ministrat Hekuran Murati dhe Donika Gërvalla, nuk ofruan asnjë përgjigje përgjatë sesionit vjeshtor, duke shpërfillur në tërësi pyetjet e kuvendarëve. Ekzekutivi i'u është përgjigjur 117 pyetjeve parlamentare, nga 299 të tilla, apo shprehur në përqindje vetëm 39% të tyre.**

<sup>14</sup> Të dhënat derivojnë nga transkriptat e publikuar në uebfaqën e Kuvendit të Kosovës, tek rubrika e 'Seancave'; e qasshme në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/seancat/seancat/>

<sup>15</sup> Rregullorja e Kuvendit, Neni 92, Paragrafi 8

|||||

|||||

**Tabela 1.3: Pyetjet e parashtruara të deputetëve ndaj Ekzekutivit dhe Përgjigjet<sup>16</sup>**

Emri/Mbiamri	SESIONI PRANVEROR		SESIONI VJESHTOR		GJITHSEJ PËR VITIN =2023	
	PYETJET	PËRGJIGJJET	PYETJET	PËRGJIGJJET	PYETJET	PËRGJIGJJET
Albin Kurti	17	17	9	0	26	17
Emilja Redzeqi	0	0	1	0	1	0
Besnik Bislimi	1	1	0	0	1	1
Albulena Haxhiu	2	1	1	1	3	2
Liburn Aliu	48	29	39	16	87	45
Arben Vitia	8	8	7	5	15	13
Faton Peci	3	3	8	4	11	7
Elbert Krasniqi	2	1	1	1	3	2
Fikret Damka	1	1	0	0	1	1
Artane Rizvanolli	10	10	2	2	12	12
Hekuran Murati	8	6	10	0	18	6
Xhelal Sveçla	13	0	9	0	22	0
Arbërie Nagavci	19	14	19	16	38	30
Rozeta Hajdari	10	8	3	1	13	9
Donika Gërvalla	10	2	2	0	12	2
Hajrullah Çeku	17	12	17	14	34	26
Armend Mehaj (ish ministër)	2	1	0	0	2	1
<b>GJITHSEJ</b>	<b>171</b>	<b>57</b>	<b>128</b>	<b>60</b>	<b>299</b>	<b>117</b>

<sup>16</sup> Të dhënat derivojnë nga transkriptat e publikuar në uebfaqën e Kuvendit të Kosovës, tek rubrika e 'Seancave'; e qasshme në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/seancat/seancat/>

|||||

Ngjashëm, në ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes, një element me rëndësi është edhe dhënia e hapësirës së duhur kohore për të trajtuar raportimet dhe raportet e institucioneve apo për të planifikuar vizita mbikëqyrëse. Kuvendi, së bashku me mekanizmat e tij, si pasojë e agjendës së ngarkuar parlamentare, një pjesë të rëndësishme të aktivitetit mbikëqyrës ndaj institucioneve apo ndërmarrjeve publike, ka dështuar ta realizoj në kohë të përshtatshme. **Trajtimi i vonuar i raporteve tejet të rëndësishme, penalizoi procesin mbikëqyrës gjatë gjithë vitit, meqë rëndësia e gjetjeve zhvlerësohet kur ato të jenë arritur muaj apo vite më vonë se që do të duhej të ishin arritur.** Për të ilustruar këtë fenomen, kemi rastin e votimit të Raportit Vjetor Financiar të Auditorit për vitin 2022 në Kuvendin i Kosovës, krejt vonë, pothuajse në fund të sesionit vjeshtor, në një seancë të 9 nëntorit.<sup>17</sup>

Në pjesën e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, e cila ushtrohet nga komisionet parlamentare, Kuvendi ka shënuar një përmirësim.<sup>18</sup> Gjatë vitit 2023 në procedurë të mbikëqyrjes së zbatimit kanë qenë 15 ligje. Gjatë sesionit pranveror komisionet kanë mbikëqyrë zbatimin e dy ligjeve, ndërsa, gjatë sesionit vjeshtor Kuvendi ka marrë vendim për mbikëqyrjen e zbatimit të 3 Ligjeve. Në tërësi Kuvendi, duke vendosur në lëvizje të gjithë mekanizmat e tij, do të duhej të bënte më tepër, në mbikëqyrje të zbatueshmërisë së ligjeve, si rezultat të rris numrin e ligjeve të mbikëqyrura dhe cilësinë e aktivitetit mbikëqyrës.

Krejt në fund, qasja joaktive e Kuvendit në ushtrimin e mbikëqyrjes, është vërejtur edhe në përdorimin e të drejtave për organizim të seancave dëgjimore.<sup>19</sup> Në bazë të Rregullores së Kuvendit, ky instrument mund të jetë i dyformshëm: dëgjim publik legjislativ<sup>20</sup> dhe dëgjim mbikëqyrës.<sup>21</sup> Në ushtrimin e të parës, Kuvendi qëndron relativisht mirë, gjatë sesionit vjeshtor ka organizuar 6 dëgjime publike, ndërsa në tërësi gjatë vitit 2023, 16 dëgjime.<sup>22</sup> **Gjendja qëndron tërësisht ndryshe tek dëgjimet mbikëqyrëse, meqë është organizuar vetëm një dëgjim mbikëqyrës, konkretisht nga Komisioni për Ekonomi, në mbledhjen e 6 dhjetorit, ku është trajtuar mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për tregti me jashtë.**<sup>23</sup>

Përgjatë këtij sesioni, por edhe vitit në tërësi, Kuvendi i Kosovës ka hasur në dallime vështirë të kalueshme për një numër çështjesh ndërsa, komisionet përkatëse nuk kontribuan në sqarimin e tyre nëpërmjet dëgjimeve mbikëqyrëse. Së paku, në dy raste, nëpërmjet prerogativës të dëgjimit mbikëqyrës të anëtarëve të ekzekutivit, do të duhej të mblidhej më tepër informacion për përmbajtjen e projektligjeve me përmbajtje të debatueshme në Kuvend. Sikurse në debatin për Marrëveshjen ndërmjet Mbretërisë së Danimarkës dhe Kosovës, për shfrytëzimin e institucionit korrektues në Gjilan, komisionet përkatëse do të duhej t'i shërbenin më tepër informimit të deputetëve. Në seancën e 23 nëntorit, në diskutime në lidhje me këtë Marrëveshje me Mbretërinë se Danimarkës debati i zhvilluar ndërmjet deputetëve në seancë, pahtësoi mungesën e theksuar të informacionit ndërmjet parlamentarëve.<sup>24</sup> Kësisoj, Komisioni për Legjislacion, do të duhej të bënte punë më të mirë mbikëqyrëse, duke organizuar mbikëqyrjeje, që t'i shërbente zhvillimit të një debati parlamentar të mbështetur tek të dhënat e kësaj marrëveshje.

Kuvendi ka performuar më mirë në organizimin e dëgjimeve publike legjislative. Organizimi i 16 dëgjimeve publike duhet të vlerësohet, porse Kuvendi duhet të organizojë më shumë dëgjime publike. Debati polemizues parlamentar i zhvilluar për Projekt-Kodin Civil, paraqet një rast kur Komisioni për Legjislacion, do të mund të lehtësonte punën parlamentare nëpërmjet organizimit të dëgjimit publik legjislativ, ku përveç shpërndarjes së informacioneve dhe të dhënave rreth temës, mbase nga debatet e tilla parlamentare mund të përvijohet rruga për tejkallim të ngërçit në lidhje me trajtimin e asaj.

Përgjithshëm, duke vlerësuar punën mbikëqyrëse të Kuvendit përgjatë vitit 2023, mund të pohohet se nuk është shënuar përparim. Krejt në të kundërtën e zhvillimeve të duhura, në disa aspekte Kuvendi ka treguar përkeqësim në mbikëqyrje dhe ngecjet janë qartazi të evidentueshme. Kuvendi, me të gjithë mekanizmat e tij, do të duhej t'i kushtonte më tepër rëndësi përmirësimit të punës mbikëqyrëse. Puna parlamentare duhet të jetë një proces politik që në thelb të saj vendosë mbikëqyrjen.

17 Lajmin në ueb-faqën e Kuvendit, i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-punimet-e-kuvendit-33784/>

18 Kushtetuta e Kosovës,

19 Rregullorja e Kuvendit, Neni 38

20 Rregullorja e Kuvendit, Neni 39

21 Rregullorja e Kuvendit, Neni 40

22 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënja në mes sfidash", f. 17; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

23 Lajmin në ueb-faqën e Kuvendit, i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/degjim-mbikëqyrës-i-komisionit-per-ekonomi-34048/>

24 Lajmi në ueb-faqën e Kuvendit, i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/kuvendi-mbajti-seancen-plenare-te-radhes-33928/>



# 3. Rregullorja dhe normalizimi i precedentëve mosrespektuese

Miratimi i Rregullores së re të Kuvendit, gjatë vitit 2022<sup>25</sup> u vlerësua si zhvillim i rëndësishëm, në sfidën e përmirësimit të punës parlamentare. Porse, mungesa e aplikimit të mirëfilltë të saj, ka bërë që efekti saj në praktikë të jetë pothuajse i papërfillshëm. **Edhe gjatë këtij sesioni, sikurse gjatë sesionit paraprak, puna parlamentare është karakterizuar më një mosrespektim të vazhdueshëm të Rregullores, deri në masën që përsëritja e precedentëve mosrespektues, ka shkaktuar një llojë praktike parlamentare që normalizon shkeljen e Rregullores së Kuvendit.** Kësisoj, Kryetari apo kryesuesi i Kuvendit, si autoriteti për interpretimin e Rregullores<sup>26</sup>, në mënyrën e vendimmarrjes së tij, do të duhej të shmangte një praktikë të intepretimeve subjektive të Rregullores – qasje kjo që tanimë ka krijuar disa precedente kundërthënëse të interpretimit të Rregullores.

**Një nga rastet më të shquara të mosushtrimit të funksionit nga ana e Kryetarit të Kuvendit, është mosdeklarimi i tij, përballë bojkotimit të pyetjeve parlamentare të ardhura nga opozita ndaj ekzekutivit.** Në kuadër të kapitullit të kontrollit parlamentar, Rregullorja i delegon kryesuesit kompetecën e tërheqjes së vërejtjes karrshi përfaqësuesve të ekzekutivit të cilët kanë qasje mospërfillëse ndaj Kuvendit, duke munguar pa arsye në seancë në kohën e pyetjeve parlamentare.<sup>27</sup> Por, qasje mospërfillëse mund të konsiderohet edhe refuzimi i anëtarit të Qeverisë i cili është prezent, por refuzon tu përgjigjet pyetjeve të deputetëve. Një situatë e tillë shpërfillëse kundrejt Kuvendit dhe deputetëve përfaqëson shkelje të rregullimit ekzisutes dhe udhëheqësi i këtij institucioni, do të duhej të mbante një qëndrim kritikues përballë ekzekutivit, me qëllimin të mos shndërrimit të bojkotit të pyetjeve parlamentare, në mjet politik. Kryetari i Kuvendit, përtej të gjithave, duhet të reflektojë për qasjen e tij – përtej njëfarë neutraliteti sikurse në këtë situatë, duhet aktivisht të veprojë, meqë ai përfaqëson autoritetin për zbatimin e Rregullores së Kuvendit.<sup>28</sup>

Kur jemi tek shkeljet e caktuara më specifike, një nga lëshimet tjera të shquara në raport me interpretimin e Rregullores, ka qenë vendosja e standartit të interpretimit të situatës së njëjtë, me vendime përfundimtare të ndryshme. Me kërkesën e 40 deputetëve, nga radhët e partive opozitare, me datën 12 tetor, është thirrur seancë e jashtëzakonshme për trajtimin e një rezolute që synonte të rregullonte ndihmën financiare për Policinë, propozim ky i ardhur nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Në rastin e mbajtjes së seancës, Kryetari Konjufca argumentoi se seanca nuk plotëson kushtet për mbajtje, për shkakun e mungesës së kuorumit.<sup>29</sup> Ndërsa, një javë më pas, në një gjendje krejtësisht identike, të mbledhur për të njëjtën çështje, ai përligji mbajtjen e seancës në rrethana të mungesës së kuorumit, duke shpjeguar se "janë dhënë arsye për mbajtjen e saj, në mbledhjen e Kryesisë."<sup>30</sup>

25 Lajmi në ueb-faqën e Kuvendit, i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/lajmi/u-miratua-rregullorja-e-re-e-kuvendit-30357/>

26 Rregullorja e Kuvendit, Neni 122, Paragrafi 1

27 Rregullorja e Kuvendit, Neni 92, Paragrafi 8

28 Rregullorja e Kuvendit, Neni 16, Par. 4

29 Lajmi në ueb-faqën e Kuvendit, i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-punimet-e-kuvendit-33478/>

30 Lajmi në ueb-faqën e Kuvendit, i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/seance-e-jashteza-konshme-e-kuvendit-33550/>





## Me kërkesën e **40 deputetëve**, nga radhët e partive opozitare, me datën **12 tetor**, është thirrur seancë e jashtëzakonshme për trajtimin e një rezolute që synonte të rregullonte ndihmën financiare për Policinë, propozim ky i ardhur nga **Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës**.

Në frymë përcaktuese të një norme kategorike, Kushtetuta e Kosovës, shkruan se kuorumi i domosdoshëm vendimarrës plotësohet me praninë e më shumë se gjysmës së deputetëve.<sup>31</sup> Kurse, Rregullorja e Kuvendi të Kosovës, shpjegon se vetëm në raste të seancave të pyetjeve parlamentare, Kuvendi mund të mbledhet edhe me kërkesën e vetëm 1/3 së deputetëve.<sup>32</sup> Tema e kuoromit të domosdoshëm arsyetohet mjaft mirë edhe në Komentarin e Kushtetutës, i cili sqaron se në interpretim të pyetjes së kuoromit, duhet të bëhet dallim ndërmjet kuoromit për vendimmarrje dhe kuoromit për diskutim.<sup>33</sup> Dështimi për të kuptuar këtë dallim, ka krijuar precedentin e mbajtjes së seancave që kërkojnë vendimmarrje, me kuorumin bazik që lejon vetëm seanca, të cilat për nga përmbajtja janë vetëm diskutuese. **Një përfundim si ky, krijoj precedentin e lejimit të seancave mbi bazë të vullnetit individual të figurave ekzekutive brenda Kuvendit, pa plotësuar kushtet e kërkuara ligjore.**

Një nga mangësitë në interpretimin e Rregullores bie në fushën e mungesës së masave ndëshkuese për deputetët, në rrethana kur ata tejkalojnë kufijtë e gjuhës parlamentare. **Duhet të potencohet që edhe gjatë sesionit të kaluar, udhëheqësi i Kuvendit duke interpretuar Rregulloren me një qasje të butë, në disa raste kishte toleruar gjuhë të papranueshme parlamentare, duke ndërmarrur masa jo adekuate karshi volumit të madh të fyerjeve të deputetëve.** Duhet kujtuar rastin e fyerjeve të deputetit Kujtim Shala, drejtuar kryeministrit Kurti<sup>34</sup>, apo gjuhën seksiste të përdorur nga zëvendës-kryeministrit Besnik Bislimi ndaj deputetes Ariana Musliu-Shoshi. **Mungesa e një qasje të duhur në shqiptimin e dënimeve, ka bërë që përdorimi i gjuhës jo-parlamentare të normalizohet, duke shnëdrruar punën e Kuvendin e Kosovës, në një mjedis fyerjesh e ofendimesh.**

Në vështrimin tonë, edhe në rastin e qasjes së ndjekur nga ekzekutivi i Kuvendit kundrejt normalizimit të gjuhës jo-parlamentare fyese, kemi të bëjme me një zbatim joadekuat të Rregullores. Rregullorja, në raste të përdorimit të gjuhës së papërshtatshme brenda seancës, përcakton 5 lloje masash: *"tërheqje e fjalës, ndërprerje e fjalës, vërejtje, vërejtje me paralajmërim për largim nga seanca, dhe largim nga seanca"*.<sup>35</sup> Me gjithë volumin e madh të fyerjeve dhe ofendimeve, Kuvendi akoma nuk ka shqiptuar ndonjë masë serioze ndëshkimore, sikurse largimin e plotë nga seanca. Duke vlerësuar në tërësi fjalorin jo-parlamentar gjatë vitin 2023, mund të pohohet që së paku në rastin Shala kundër Kurtit, Kryetari i Kuvendit, ka shqiptuar masë jo të përshtatshme me përkufizimet që Rregullorja shpjegon si kontekste ndëshkimore.

31 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 69, Par. 3; e qasshme në vegëzën: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

32 Rregullorja e Kuvendit, Neni 92, Par. 9

33 Enver Hasani dhe Ivan Čukalović, "Komentari i Kushtetutës së Kosovës", f. 278-279

34 Lajmi në ueb-faqën e Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-seanca-plenare-e-kuvendit-32190/>

35 Rregullorja e Kuvendit, Neni 64





Fjalori fyes dhe denigrues i përdorur nga deputeti Kujtim Shala, në drejtim të kryeministrit Kurti, plotësoi të gjithë kushtet, që masa e 'largimit nga seanca' të shqiptohet. "Kur deputeti ose anëtari i Qeverisë përdor fjalë fyese, cenon personalitetin e Kryesuesit apo deputetit"<sup>36</sup> shpjegohet si rrethana kur kushtet për largim të jenë plotësuar – rrethana, të cilat, deklarata e deputetit Shala i ka përmbushur në tërësi. Për më tepër, edhe mungesa e reflektimit nga ana e deputetit në fjalë, pas masës së shqiptuar dhe qasja cinike në raport me 'dënimin' paraqet rrethanën e "vazhdimin të shkeljes"<sup>37</sup> pas masës së ndërmarrur paraprakisht, që përcaktohet si kusht për "largimin nga seanca". Kështu, në rastin Shala-Kurti, edhe pas shqiptimit të masës më të lehtë, ka mungesë të reflektimit apo kërkimfaljes, që Rregullorja e shpjegon "formë për anulimin e masës paraprake"<sup>38</sup> të ndërmarrur nga kryesuesi dhe qasja "recidiviste" e ndjekur nga deputeti Shala, paraqesin rrethanë tërësisht të plotësuar, për shqiptimin e masës së largimit të deputetit në fjalë.

Ngjashëm edhe në rastin e përlëshjes fizike ndërmjet disa deputetëve dhe anëtarëve të ekzekutivit, Kryetari Konjufca, ndjeku një qasje të interpretimit të Rregullores, jo shumë duke u mbështetur në fjalën e përcaktimit të Rregullores, sa në një mënyrë subjektive të të lexuarit të saj. Në seancë e 13 korriku, pas konfrontimit fizik ndërmjet deputetëve opozitarë të PDK-së dhe anëtarëve të kabintetit dhe deputetëve nga radhët e Vetëvendosjes,<sup>39</sup> kryetari Konjufca disa orë më vonë, pa konsideruar deklaratimet e të grupeve parlamentare që pohonin për mungesën e kushteve për mbajtjen e seancës, vendosi të ftonte deputetët të riktheheshin për vazhdim të seancës, ndonëse kushtet mbeteshin akoma të tensionuara. Rregullorja e Kuvendit saktëson që "në rast të rrëmujës, kryesuesi mund të ndërpresë seancën."<sup>40</sup> Mirëpo, situata e seancës së 13 korrikut, tejkalon përshkrimin e një rrëmuje të zakonshme – ngjarja e ndodhur në atë seancë bëri të pamundur vazhdimin e punës parlamentare, në një mënyrë që do të plotësonte kushtet. Për më tepër, skandaloz, ishte vendim që të vazhdohej seanca, pa e përdorur asnjë nga masa ndëshkimore që shtrihen në diskrecionin e Kryetarit. Vazhdimi pa shqiptuar masën ndëshkimore të përjashtimit<sup>41</sup>, për cilindo anëtar të përfshirë në rrahje, qoftë nga kuvendarët apo anëtarët e ekzekutivit, paraqet rast të paprecedent të refuzimit për të zbatuar Rregulloren e Kuvendit.

Krejt në fund, përgjatë vitin 2023, kemi një rast të tejkalimit të kompetencave, që Rregullorja i delegon për Kryetarin apo kryesuesin e Kuvendit. Gjatë hapësirës së pyetjes parlamentare, në seancën e 20 prillit, Kryetari Konjufca, shprehet se deputetët për shkak të mungesës nuk do të ketë mundësinë e parashtimit të pyetjeve për herë të dytë, duke i "djegur pyetjen parlamentare."<sup>42</sup> Një veprim si ky, nuk mbështetet në asnjë nga materialet që rregullon raportet ndërmjet zyrtarëve në Kuvend dhe kjo paraqet një praktikë krejtësisht arbitrare që nuk përkon me domenin e veprimtarisë parlamentare. Kryetari Konjufca, përtej përpjekjes për të administruar seancat dhe rrethanat në Kuvend, nëpërmjet vlerësimeve subjektive individuale, vendimmarrjen do të duhej ta mbështeste më tepër në përcaktimet e Rregullores së Kuvendit. Vullneti i Kryetarit, duhet të shtrihet në përkufizimet e Rregullores, dhe jo anasjelltas, sikurse gjatë vitin 2023, t'i mbivendoset asaj.

Përfundimisht, në kuadër të administrimit të seancave në Kuvend, Rregullorja e re, nuk përmbushi pritshmëritë – kjo për shkakun e mënyrës jo adekuate të interpretimit dhe zbatimit të saj. Në pikëpamje të cilësisë së debatit, riklasifikimi i mundësive ndëshkimore<sup>43</sup> në Rregulloren e tanishme, për çështje sikurse gjuha joparlamentare dhe fjalori i papërshtatshëm cenues, nuk shkaktuan ndonjë ndryshim të ri. Kështu, Kuvendi nuk vuan mungesën e një dokumenti rregullues që saktëson detajshëm normat dhe rrethanat e pranueshme, porse ngjashëm nuk mund të pohohet për vullnetin për të interpretuar atë.

**Qartazi, vullneti për të vendosur rendin bazuar në Rregullore mungon në Kuvendin e Kosovës.**

36 Rregullorja e Kuvendit, Neni 66, Paragrafi 1

37 Rregullorja e Kuvendit, Neni 66, Paragrafi 1

38 Rregullorja e Kuvendit, Neni 65, Paragrafi 4

39 Lajmi në ueb-faqën e Kuvendit, i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-punimet-e-seances-plenare-te-rregullt-dhe-33075/>

40 Rregullorja e Kuvendit, Neni 67

41 Rregullorja e Kuvendit, Neni 66, Paragrafi 1

42 TRANSKRIPTA E KUVENDIT, Mbledhja 20/04/2023, f. 44; i qasshëm në vegëzën: [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Session-Files/2023\\_04\\_20\\_ts\\_Seanca\\_10\\_00\\_eeqKrijDquU.pdf?fbclid=IwAR1ibSrztqT2FbrzQvt6YDp163l2Qdk69iB60JUvxoCmDb8Bq0xix1j\\_9ko](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Session-Files/2023_04_20_ts_Seanca_10_00_eeqKrijDquU.pdf?fbclid=IwAR1ibSrztqT2FbrzQvt6YDp163l2Qdk69iB60JUvxoCmDb8Bq0xix1j_9ko)

43 Shih dallimet ndërmjet Rregullores në çështjen e masave të mundshme për shqiptim. Rregullorja e Vjetër e Kuvendit, 2010, e qasshme në vegëzën: [http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/Rr\\_K\\_RK\\_29\\_04\\_2010\\_shqip.pdf](http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/Rr_K_RK_29_04_2010_shqip.pdf). Rregullorja e re, 2022, e qasshme në vegëzën: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61266&fbclid=IwAR2pkg1WSEcTI3ZFBSGcbPz0Vh5lt7ysr9nvzgmndq-6nYhvlijBQF00qKQ>







## 4. Sjellja e Deputetëve dhe Mungesat në punimet e Kuvendit

Edhe gjatë këtij sesioni dhe gjatë gjithë vitit 2023 papërgjegjësia ndaj punës parlamentare ishte mëse evidente. Puna parlamentare është shoqëruar nga sfidat e zakonshme siç ishte mungesa e kuorumit<sup>44</sup> e shkaktuar nga mungesat e deputetëve.<sup>45</sup> Ndërsa edhe kur ishin prezent deputetëve iu mungonte një seriozitet në lartësinë që e kërkon funksioni i ligjvënësit – veçanërisht, shumë prej tyre kanë normalizuar përdorimin e fjalorit të papranueshëm ofendues. Gjithë kjo qasje, krijoi kushtet e përshtatshme të këtij trendi rëniejeje dhe përkeqësimi, që arriti deri tek përlëshja fizike gjatë sesionit të kaluar.<sup>46</sup>

Bojkotimi që deputetët nga radhët e Listes Serbe po i bëjnë punës parlamentare, mund ta ketë rritur numrin drastikisht, porse mungesa mbi një nivel të tolerueshëm gjenden edhe në grupet e tjera parlamentare. Trende të papranueshme të mungesave ishin zhvilluar edhe gjatë sesionit të kaluar, ku në çdo seancë kanë munguar 22,5% e deputetëve. Në këtë trend sjelljeje të papërgjegjshme, në përjashtim të Listes Serbe, prinin partitë opozitare – Lidhja Demokratike me 21%, Partia Demokratike me 19%, Aleanca për Ardhmërinë me 18%, Komunitetet me 14%. Krejt në fund, deputetët e Vetëvendosjes, në perspektivë të numrave, qëndronin paksa më mirë, me vetëm 9% të deputetëve të munguar për seancë.



Trende të papranueshme të mungesave ishin zhvilluar edhe gjatë sesionit të kaluar, ku në çdo seancë kanë munguar **22,5% e deputetëve**. Në këtë trend sjelljeje të papërgjegjshme, në përjashtim të Listes Serbe, prinin partitë opozitare – Lidhja Demokratike me **21%**, Partia Demokratike me **19%**, Aleanca për Ardhmërinë me **18%**, Komunitetet me **14%**. Krejt në fund, deputetët e Vetëvendosjes, në perspektivë të numrave, qëndronin paksa më mirë, me vetëm **9% të deputetëve** të munguar për seancë.

44 Raporti i Komisionit Europian 2023, f. 9; i qasshëm në vegëzën: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD\\_2023\\_692%20Kosovo%20report\\_0.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf)

45 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënja në mes sfidash", f. 9-10; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

46 "Përlëshje fizike në seancën e Kuvendit", në platformën Kallxo, i qasshëm në: <https://kallxo.com/lajm/perleshje-fizike-ne-seancen-e-kuvendit/>



|||||

**Tabela 1.5: Mungesat e deputetëve në Seanca**

SUBJEKTI POLITIKE	Sesioni pranveror			Sesioni vjeshtor			Gjithsej për vitin 2023		
	MAX	MUN	%	MAX	MUN	%	MAX	MUN	%
VV – 56	2016	183	9%	1120	206	18,3%	3136	389	12,4%
PDK – 18	648	129	19%	360	62	17,2%	1008	191	18,9%
LDK – 16	576	122	21%	320	88	27,5%	896	210	23,4%
AAK – 8	288	52	18%	136	16	11%	448	73	16,2%
KOMUNITETET – 8	288	41	14%	136	33	24%	448	83	18,5%
LISTA SERBE – 12	432	431	99,7%	240	226	94%	672	657	97,7%
Deputet i pavarur – 2	72	9	25 %	40	9	17%	112	12	22%
<b>TOTALI:</b>	<b>4320</b>	<b>972</b>	<b>22,5 %</b>	<b>2040</b>	<b>533</b>	<b>26%</b>	<b>6720</b>	<b>1585</b>	<b>23,5%</b>

Sesioni vjeshtor, krahasuar proporcionalisht me atë pranveror, ka treguar rritje të numrit të mungesave të deputetëve, në përjashtim të një lëvizje përmirësuese tek Aleanca për Ardhmërinë dhe Partia Demokratike, të cilat kanë demonstruar trende uljeje. Kurse partia në pushtet ka treguar shenja përkeqësimi – deputetët nga radhët e Vetëvendosjes, kanë munguar në 17% të seancave, shifër kjo që përfaqëson rritje të konsiderueshme. Ngjashëm vepruan deputetët nga radhët e LDK-së, të cilët ndonëse kishin proporcionet më të larta të mungesave në sesionin e kaluar, vazhduan në ngritje të tyre, nga 21% të deputetëve që mungojnë, në 27 % të tyre. Mbase një nga arsyet që shkaktoi këtë rritje të dukshme gjatë sesionit vjeshtor është bojkotimi reciprok i një numri seancash nga palët tjera – sikurse bojkotimi i seancave të thirrura nga opozita prej deputetëve të partisë në pushtet.

**Bilanci vjetor i mungesave, në gjuhë numrash, qartëson konkretisht që në secilën seancë, 23,5% e deputetëve munguan, apo shprehur në numra, 1586 herë, për 12 muaj të vitit 2023.** Në një listim që përjashton deputetët që vinë nga Lista Serbe, LDK prinë me 23,4% të mungesave, duke u pasuar nga PDK 18,9%, Komunitetet 18,5%, AAK 16,2%, VV 12,4%. Mungesat në këto trende dëmtojnë punën parlamentare, kurse për krerët e partive politike dhe posaçërisht për drejtuesit e Kuvendit duhet të jetë një nga problemet më serioze të cilën ata duhet ta adresojnë.

Pasqyra e shpërndarjes së mungesave në numër më të lartë tek deputetët e partive opozitare, shfaqet edhe në renditjen individuale të deputetëve që munguan më së tepërmi. Nga 5 deputetët që me mungesat më të shumta, 4 vinë nga partitë opozitare. Numri i lartë i mungesave të deputetëve në tabelën e mëposhtme, janë fakte që tregojnë për mospërfshirjen e dy liderëve të partive opozitare në punën parlamentare njëmend, gjë e cila duhet të kritikohet.

|||||

|||||

**Tabela 1.6: Deputetët me numrin më të madh të mungesave**

Emri/Mbiemri	Numri i Mungesave
LUMIR ABDIXHIKU	44
BEHGJET PACOLLI	39
MEMLI KRASNIQI	35
ARDIAN KASTRATI	34 <sup>47</sup>
SARANDA BOJUEVCI	24 <sup>48</sup>

Ngjashëm, sfidë për Kuvendin vazhdon të mbetet përdorimi i gjuhës me përmbajtje ofenduese dhe seksiste, që përgjithshëm shpjegohet, në emërtimin gjuhë jo-parlamentare. Gjatë këtij sesi, porse edhe në kendvështrimin e plotë të vitit, Kuvendi nuk tregoi asnjë nga shenja që do të mund të shpresonim për një përmirësim. Kuvendi prodhoi ngjarje të kësaj natyre, në numër aq të konsiderueshëm, sa që ka normalizuar një komunikim të papranueshëm, shpeshherë verbal dhe pa përmbajtje politike – përveç ofendimit kundrejt palës tjetër në argument.

Gjatë muajit nëntor ka filluar hartimi i këtij Kodi të titulluar Kodi i Sjelljes për deputetët, dokument ky që pjesërisht synon të saktësojë rrethanat ndëshkuese, të përcaktuara në Rregullore të Kuvendit, dhe pjesërisht të vendos rregullim plotësues të vetë Rregullores. Procesi të hartimit të Kodit, nuk është mirëpritur nga deputetët – konsensusi për domosdoshmërinë e një dokumenti të tillë mungoi, edhe kur rrethanat qartësojnë imperativin e ekzistencës së tij. Kësisoj, përafrimi i partive politike në temën e Kodit të Etikës, duhet të kritikohet, me fokusin tek deputetët që duhet ta mirëpritnin një proces si ky. Disa nga deputetët kanë kushtezuar miratimin e Kodit me ligje të caktuara, duke shpërfaqur një neglizhencë ndaj rolit dhe përgjegjësisë personale.

**Gjendja në Kuvend ilustron nevojën e një dokumenti të tillë, pa hamendje. Porse ekziston rreziku i të kuptuarit të Kodit të Sjelljes, si një kusht formal, pa u përpjekur që t'i shtohet përmbajtje cilësore, që njëmend synon përmirësimin e situatës, qoftë edhe me masa ndëshkimore.** Prandaj, ekzistenca e Kodit, mund të krijojë iluzionin e vendosjes së rregullit, kurth ky që nuk do të përmirësonte asgjë në punën parlamentare.

KDI, ka marrur pjesë në grupin punues për hartimin e Kodit të Etikës. Në vlerësimin tonë, formati fillestar i Kodit ka shfaqur mangësi, të cilat duhet të rishikohen, në mënyrë që vetë dokumenti i Kodit të mund të përmirësojë sadopak situatën. Në versionin e parë, parashihet masa ndëshkimore për deputetin/en që konstatohet të ketë vepruar në formë të papranueshme, të jetë 2% e pagës<sup>49</sup> – masë kjo tejet e ultë, ekzistenca e të cilës, nuk do të përmirësojë aspak gjendjen në Kuvend. Në këtë pikë, Kuvendi duhet të konsultohet me Kodet e Etikës të vendeve në regjion, për të brendësuar praktikatat më të mira. Si një model për të shqyrtuar, Kodi i Sjelljes në Serbi pas tërheqjes së vërejtjes, parasheh masa deri në 50% të pagës.<sup>50</sup> Kurse modele sikurse Kodi i Sjelljes në Maqedoni i cili për sjelljet e mundshme që bien në kundërshtim me Kodin, nuk përcakton saktësisht shqiptimin e ndonjë mase ndëshkimore specifike<sup>51</sup> apo Kodi i Sjelljes në Mal të Zi, që mjaftohet vetëm me publikimin e vërejtjes publike<sup>52</sup> nuk duhet të shërbejnë si mostra për ti konsideruar. Në formë të ngjashme, modeli i Kodit të Sjelljes së shtetit shqiptar, nuk precizohet ndonjë masë ndëshkimore, duke u mjaftuar me përcaktimet ekzisutese të Rregullores.<sup>53</sup>

47 Deputeti Ardian Kastrati raportohet sa ka munguar për arsye shëndetësore.

48 Deputetja Saranda Bogujevci raportohet sa ka munguar për arsye shëndetësore dhe ka qenë në pushimin e lehonisë.

49 Kodi i Etikës, Neni 28, Paragrafi E, f. 11

50 CODE OF CONDUCT FOR MEMBERS OF PARLIAMENT REPUBLIC OF SERBIA, Article 31, Par. 5, p. 9

51 CODE OF ETHICS FOR THE MEMBERS OF PARLIAMENT IN THE ASSEMBLY OF THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA, i qasshëm në vegëzën: <https://legislationline.org/sites/default/files/documents/7a/Annex%20OSCE%20DIHR%20Opinion%20on%20the%20Draft%20Code%20of%20Ethics%20for%20the%20Members%20of%20the%20Assembly%20of%20the%20Republic%20of%20North%20Macedonia.pdf>

52 CODE OF ETHICS FOR MPS MONTENEGRO, Article 18, p. 4

53 Kodi i Sjelljes së Deputetëve, Neni 6, Par.3, i qasshëm në vegëzën: <https://staging.parlament.al/Files/RaporteStatistika/Kodi%20i%20Sjelljes.pdf>

|||||



# 5. Trajtimi i legjislativitetit për Reformën në Drejtësi

Reforma në drejtësi, edhe në vitin 2023, ka zënë vend të shquar në procesin e ligjvënies. Një fakt i rëndësishëm në shpjegimin e volumit të punës legjislativitet me përmbajtje të kësaj fushe është se ekzekutivi aktual rrjedh nga një projekt politik, në qendër të së cilit ka vendosur vazhdimin e reformave në drejtësi.<sup>54</sup> Për të ilustruar këtë fokus në reformin e sektorit të drejtësisë, vlen të kujtohet se Programi Legjislativ për vitin e 2022, kishte 19 projektligje të ndërlidhura me Reformën në Drejtësi, draftimin e të cilave ekzekutivi planifikonte të realizonte.<sup>55</sup> Ngjashëm, në Programin Legjislativ për vitin 2023 i kushtohet një hapësirë substanciale, reformimit të drejtësisë. Në tërësi ky plan kishte 10 projektligje që përfshihen në domenin e reformës, me Ministrinë e Drejtësisë si sponzorizuese të tyre.<sup>56</sup>

Kështu, 17 ligje nga 71 ligje të miratuara në Kuvend këtë vit kanë qenë ligje të reformës në drejtësi. Rrjedhimisht 24% e legjislativitetit të miratuar ka qenë për reformën në drejtësi. Në procedurë të shqyrtimit janë edhe tri projektligje në kuadër të reformës.

**Në sesionin vjeshtor ndër zhvillimet kyçe, nga vështrimi i reformës së drejtësisë, është hartimi për herë të dytë i Projektligjit për Këshillin Prokurorial, pasi versionin e parë të këtij Ligji, Gjykata Kushtetuese e kishte vlerësuar si të papajtueshëm, me Kushtetutën.** Ligji në fjalë, ishte miratuar në qershor të vitit 2022, megjithëse shqyrtimi i tij kishte prodhuar polemika të shumta ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës. Të dy këto institucione, të vendosura në këndvështrime të ndryshme, nxirrnin përfundime të largëta mbi përmbajtjen e këtij Ligji.

Në kontestin e ligjit të sipërpërmendur janë bashkuar edhe partitë opozitare të cilat, gjykan përpjekjen qeveritare për një reformim të atij lloji, si një përpjekje për ndikim mbi Këshillin Prokurorial. Kështu filluar nga deputët nga radhët e Partisë Demokratike në një rast,<sup>57</sup> më pastaj, nga deputetët e Lidhjes Demokratike ndaras në një tjetër rast,<sup>58</sup> përmbajtja e projektligjit ishte ankumuar pranë Gjykatës Kushtetuese – me pretendimin e papajtueshmërisë në raport me Kushtetutën. Këto pretendime, Gjykata i pati arsyetuar, në një opinion miratues të palëve pretenduese, duke afirmuar cënueshmërinë e Kushtetutës përballë këtij Ligji.<sup>59</sup>

54 "Alternativa për Shtetin e së Drejtës", i qasshëm në ueb-faqën e Lëvizjes Vetëvendosje, në vegëzën: <https://www.vetevendosje.org/alternativa/shteti-i-se-drejtjes/>

55 Programi Legjislativ për Vitin 2022; i qasshëm në ueb-faqën e Qeverisë, në vegëzën: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/07/Programi-Legjislativ-per-Vitin-2022-.pdf>

56 Programi Legjislativ për Vitin 2022; i qasshëm në ueb-faqën e Qeverisë, në vegëzën: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/01/Programi-Legjislativ-per-vitin-2023-25.1.2023.pdf>

57 Lajmin për dorëzimin e kësaj lënde e gjeni në ueb-faqë e PDK-së, i qasshëm në vegëzën: <https://pdk.info/article/abelard-tahiri-dore-zon-ne-kushtetuese-ligjin-per-keshillin-prokurorial-te-kosoves-cenon-rende-pavaresine-e-gjyqesorit>

58 Betimi për Drejtësi, "Edhe LDK-ja e dërgon në Kushtetuese Ligjin për Këshillin Prokurorial", i qasshëm në vegëzën: <https://betimiperdrejtesi.com/pdk-e-dergon-ne-gjykatën-kushtetuese-ligjin-per-keshillin-prokurorial/>

59 Njoftimi për vendim në rastin KO 100/22 dhe KO 101/22; i qasshëm në vegëzën: <https://gjk-ks.org/njoftim-per-vendim-ne-rastin-ki-100-22-dhe-ki-101-22/>





**22 dhjetor** Gjykata ka publikuar opinionin e saj lidhur me këto amendamente mbi të cilat ka ofruar disa vërejtje të cilat duhet të adresohen nga Komisioni. Pas kësaj sfida qëndron tek votimi i amandamenteve, për të cilat nevojiten **2/3 e votave** të deputetëve shqiptar dhe **2/3 e votave** nga komunitetet jo shumicë. Partitë më të mëdha opozitare janë zotuar për votimin e tyre, por jo edhe ata të komunitetit serb të cilët për muaj me rrdhë janë duke bojkotuar punimet e Kuvendit.

Në periudhën pasuese, Ministria e Drejtësisë, duke shqyrtuar mësimet nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, filloi rishkrimin e këtij Projektligji, proces ky që mbaroi në korrik të 2023.<sup>60</sup> Në vështrimin e Këshillit Prokurorial, formati ri i Ligjit për Këshillin Prokurorial dallon vetëm sipërfaqësisht, meqë edhe versioni i ridraftuar cenon pavarësinë e këtij institucioni.<sup>61</sup> Përmbajtja e Ligjit të shkruar ëdhe pas reflektimit] mbetet të jetë e diskutueshme, rrjedhshëm edhe polemikat në mes të bartësve të institucioneve. Gjithsesi, mbetet për zbulim, nëse kësaj radhe përmbajtja e projektligjit të draftuar do të kontestohet sërish pranë Gjykatës Kushtetuese.

Në fushën e reformës në drejtësi, fillimi i procesit të Vettingut paraqet një nga zhvillimet më të shquara. Në fund të vitit të kaluar, pas miratimit të Koncept-dokumentit për zhvillimin e procesit të Vettingut në Qeveri,<sup>62</sup> Kuvendi kishte themeluar një komision Ad-Hoc, për të përgatitur draft amendamentet kushtetuese dhe Projektligjin për Vettingun.<sup>63</sup> Komisioni kryesohej nga opozita, derisa mandatin fillestar e kishte të kufizuar në 6 muaj. Në vështirësi për të trajtuar këtë çështje komplekse, brenda këtij afati kohor, Komisioni në një procedurë të zakonshme, kërkoi zgjatjen e mandatit edhe për 6 muaj tjerë. Pas finalizimit të draft amandamenteve nga ana e Komisionit ato u dërguan në Gjykatën Kushtetuese nga ana e Kryetarit të Kuvendit me 2 mars të vitit 2023. Së fundi me 22 dhjetor Gjykata ka publikuar opinionin e saj lidhur me këto amendamente mbi të cilat ka ofruar disa vërejtje të cilat duhet të adresohen nga Komisioni. Pas kësaj sfida qëndron tek votimi i amandamenteve, për të cilat nevojiten 2/3 e votave të deputetëve shqiptar dhe 2/3 e votave nga komunitetet jo shumicë. Partitë më të mëdha opozitare janë zotuar për votimin e tyre, por jo edhe ata të komunitetit serb të cilët për muaj me rrdhë janë duke bojkotuar punimet e Kuvendit.

KDI, ka asistuar në procesin trajtues të Vettingut, nëpërmjet ofrimit të ekspertizës, të prezentuar në takimet e grupit punues. Përgjithshëm KDI, ka adaptuar një qëndrim që përligj reformën e Vettingut, në rrethana kur ajo zhvillohet vetëm nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese, në një proces gjithëpërfshirës, ku të gjithë pjesëmarrësit njohin domosdoshmërinë e reformës dhe veprojnë në drejtim të jetësimit të saj. Prandaj, reforma e Vettingut, duhet të jetë rezultat i një procesi të ekuilibruar të komunikimit ndërmjet institucioneve. Në vlerësimin tonë, bashkëpunimi ndërmjet aktorëve kyç, i takon një rëndësie përcaktuese – politika duhet të kuptojë se nuk mund të mbivendos vullnetet e saja mbi institucionet e pavarura të drejtësisë në një formë të njëanshme, ndërsa përfaqësuesit e institucioneve të drejtësisë, duhet të njohin realitetin se gjendja ekzistuese është e pamjaftueshme.

60 "Mbledhja e 151-të e Qeverisë së Republikës së Kosovës"; Lajmi në ueb-faqën, i qasshëm në vegëzën: <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/mbledhja-e-151-te-e-qeverise-se-republikes-se-kosoves/>

61 "Këshilli Prokurorial i Kosovës reagon ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për miratimin e Projektligjit të ri për KPK-në"; Lajmi në ueb-faqën e KPK-së, në vegëzën: <https://prokuroria-rks.org/kpk/lajm/9946>

62 "Koncept-dokumentit për zhvillimin e procesit të Vettingut"; Teksti i tij i qasshëm në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/09E907A6-06B2-4DBF-AB8B-E2793F4B9049.pdf>

63 Informacioni në ueb-faqën e Kuvendit, i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/lajmi/seanca-plenare-e-kuvendit-31435/>



**KDI**, ka asistuar në procesin trajtues të Vetingut, nëpërmjet ofrimit të ekspertizës, të prezentuar në takimet e grupit punues.

Përgjithshëm **KDI**, ka adaptuar një qëndrim që përlligjë reformën e Vettingut, në rrethana kur ajo zhvillohet vetëm nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese, në një proces gjithëpërfshirës, ku të gjithë pjesëmarrësit njohin domosdoshmërinë e reformës dhe veprojnë në drejtim të jetësimit të saj.

Në nga Ligjet më të dalluara në fushën e reformimit të sektorit të drejtësisë, puna e të cilit është zhvilluar pjesërisht gjatë vitit 2023, ishte edhe Ligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, i cili është miratuar në seancën e 9 shkurtit.<sup>64</sup> Ngjashëm, sikurse në një numër rastesh që prekin fushën e drejtësisë, një pjesë e opozitës, këtë Projektligj e vlerësoi me përmbajtje kundërthënëse, përballë përcaktimeve kushtetuese. Kësisoj, Partia Demokratike e Kosovës e kontestoi përmbajtjen e tij, duke e dërguar në Gjykatën Kushtetuese.<sup>65</sup> Anipse kanë kaluar mbi 10 muaj, për Projektligjin për Byronë, Gjykata Kushtetuese nuk ka publikuar ende një vendim. Gjendja e përmbajtjes së këtyre ligjeve për nga pikëpamja e rëndësisë në reformën në drejtësi, vë në pikëpyetje aftësitë teknokratike të ekzekutivit për të drejtuar një proces kaq të ndjeshëm, gjersa koha jo shumë e zakonshme e trajtimit të këtyre nga ana e Gjykatës Kushtetuese, ngre hamendje për të ardhmen e reformës në tërësi.

Edhe në grupet punuese të Projektligjit për Byronë Shtetërore, KDI, është bërë pjesë e punimeve vazhdueshëm përmes ofrimit të ekspertizës.<sup>66</sup>

Përgjithshëm, Ligjet që përfshihen në kuadër të reformës së drejtësisë dhe që kanë marrur miratimin e kuvendarëve gjatë vitit 2023 janë këto: Ligji për Prokurorinë Speciale, Ligji për Prokurorin e Shtetit, Ligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të procedurës penale, Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit penal etj.

Ndërsa, dështimi i trajtimit të Projekt-Kodit Civil të Kosovës paraqet një zhvillim negativ për Kuvendin, përgjegjësia për të cilin, duhet të bie mbi çdonjërin parti dhe individualisht mbi secilin deputet. Të drejtat civile që rregullon ky dokument, do të duhej të ishin imperativ për deputetët, pavarësisht përcaktimeve partiake.

64 Informacioni në ueb-faqën e Kuvendit, i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/lajmi/kuvendi-miratoi-projektligjin-per-ndryshimin-31823/?fbclid=IwAR3RjVnpXNnrPR8VVMUdEfyiZ6NW1FWTq1GtU98qxev0EtQz2g0Vzqd-Ro0>

65 "PDK e dërgon në Kushtetuese Ligjin për Byronë Shtetërore për konfiskim të pasurisë"; Lajmi në platformën Kallxo, i qasshëm në vegëzën: <https://kallxo.com/lajm/pdk-e-dergon-ne-kushtetuese-ligjin-per-byrone-shteterore-per-konfiskim-te-pasurise/>

66 "DRAFT-OPINION ON THE DRAFT LAW N°08/L-121 ON THE STATE BUREAU FOR VERIFICATION AND CONFISCATION OF UNJUSTIFIED ASSETS"; Opinioni është i qasshëm në vegëzën: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL\(2022\)014-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL(2022)014-e)



## 6. Transparenca ndaj publikut

Një nga parimet bazë të punës parlamentare, vlerësohet të jetë transparenca, si mënyra më e përshtatshme që i ndihmon informimit dhe llogaridhënies më të mirë ndaj publikut. Në pikëpamje të transparencës, gjendja gjatë vitit 2023 nuk ka ndryshuar aspak, me Kuvendin që nuk ka vepruar për përmirësim në kohën e duhur të mangësive të cilat veçse janë të njohura. Ndonëse, tenderi për tu pajisur me mjetet teknologjike që mundësojnë votimin elektronik është shpallur me datë 30 nëntor 2023, duke vlerësuar tejzgjatjen e këtij procesi, pak nga ky vendim mbetet për tu vlerësuar. Për më tepër, kur vlerësohen dështimet paraprake në procesin tenderues, gjërat bëhen akoma më pesimiste, në rikthimin e votimit elektronik në Kuvend. Duhet të theksohet, së kjo problematikë është përfshirë edhe në Raportin e Progresit, si një çështje që duhet adresuar.<sup>67</sup>

Problemi i transparencës në Kuvend nuk kufizohet vetëm tek mungesa e votimit elektronik. Përveç kësaj, ka një papajtueshmëri shifrash ndërmjet aktivitetit që zhvillojnë komisionet dhe dokumenteve që publikohen nga Kuvendi për këto Komisione. Të dhënat tregojnë që numri i dokumenteve të publikuara është më i vogël se numri i mbledhjeve – mungojnë publikimet e dokumenteve pasuese të mbledhjeve, sikurse procesverbalet e mbledhjeve.<sup>68</sup>

Mospublikimi i dokumenteve të përshkruara më lartë dëmton transparencën e punës së Kuvendit. Në tabelën e mëposhtme gjeni të dhënat që pasqyrojnë këtë mungesë transparence. Nga 358 organizime të komisioneve – qofshin ato mbledhje, dëgjime publike apo dëgjime mbikëqyrëse – vetëm 201 nga këto kanë të publikuara në Kuvendin e Kosovës dokumentet pasuese, sikurse proces verbali, ndërsa obligimi për të publikuar transkriptin e mbledhjes, i përcaktuar nga Rregullorja e Kuvendit<sup>69</sup>, në masë të madhe të nuk është përfillur. Gjatë sesionit vjeshtor, vetëm Komisioni për Ekonomi, dhe atë në dy raste ka publikuar transkriptin e mbledhjeve.<sup>70</sup> Përfundimisht, afërsisht 41% e organizimeve të komisioneve nuk janë raportuar në portofolion e tyre, në faqën e Kuvendit, kurse transkriptat e atyre të publikuarave mungon në mbi 95% të rasteve.

67 Raporti i Komisionit European 2023, f. 8; i qasshëm në vegëzën: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD\\_2023\\_692%20Kosovo%20report\\_0.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf)

68 Shih të dhënat në ueb-faqën e Kuvendit, tek Rubrika "Komisionet", në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/komisionet/>

69 Rregullorja e Kuvendit, Neni 117, Par.6, Pika.2; i qasshëm në vegëzën: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61266&fbclid=IwAR2pk-g1WSEcTI3ZFBSCbPz0Vh5lt7ysr9nvzgMnda-6nYhvijlBQF00qKQ>

70 TRANSKRIPT I DËGJIMIT PUBLIK, 18/10/2023, i qasshëm në vegëzën: [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocument-Files/2023\\_10\\_26\\_\(18\\_10\\_2023\)TRANSKRIPTIIDEGJIMTPUBLIKPERPROJEKTILIGJINPERFONDINSOVRANTEREPUBLIKESSEKOSOVES18tetor2023\\_ts-F4AYrt3e.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocument-Files/2023_10_26_(18_10_2023)TRANSKRIPTIIDEGJIMTPUBLIKPERPROJEKTILIGJINPERFONDINSOVRANTEREPUBLIKESSEKOSOVES18tetor2023_ts-F4AYrt3e.pdf) ;

TRANSKRIPT I DËGJIMIT PUBLIK, 5/12/2023, i qasshëm në vegëzën: [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocument-Files/2023\\_12\\_12\\_\(05\\_12\\_2023\)TRANSKRIPTDEGJIMPUBLIKperprojektiligjinperBRE5.12.2023\\_k95HxpAwTR.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocument-Files/2023_12_12_(05_12_2023)TRANSKRIPTDEGJIMPUBLIKperprojektiligjinperBRE5.12.2023_k95HxpAwTR.pdf)



**Tabela 1.4: Publikimi i procesverbaleve të Komisioneve në krahasim me mbledhjet e mbajtura**

Komisionet
Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere
Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit
Komisioni për Integrim Evropian
Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë
Komisioni për Arsime, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport
Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti
Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim
Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal
Komision për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione
Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike
Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Intelegjencë
Komisioni Hetimor për Rezerva
Komisioni Hetimor për Dhunën në Familje

**Ndërsa akoma edhe më keq është situata tek Komisionet Ad-Hoc dhe Komisionet Hetimore, aktiviteti i të cilëve mbetet krejtësisht i panjohur për publikun.** Për punën e këtyre komisioneve, Kuvendi nuk publikon as lajme njoftuese që informonin qytetarët për punën e zhvilluar në mbledhje dhe temat e trajtuara nga këto komisione dhe as procesverbale. Mungesa e plotë e portofolive të këtyre komisioneve paraqet problem të madh në transparencën e punës së Kuvendit, veçanërisht kur dihet përmbajtja e ndjeshme e punës së këtyre komisioneve.

71 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënja në mes sfidash", f. 23; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>





|||||

Sesioni pranveror <sup>71</sup>		Sesioni vjeshtor		Gjithsej për vitin 2023	
Numri i mbledhjeve	Numri i procesverbaleve të publikuara	Numri i mbledhjeve	Numri i procesverbaleve të publikuara	Numri i mbledhjeve	Numri i procesverbaleve të publikuara
23	9	18	2	41	11
11	9	7	1	18	10
20	10	10	10	30	20
12	9	6	5	18	14
7	7	5	5	12	12
13	6	11	4	24	10
24	21	15	14	39	35
15	14	11	5	26	19
22	17	12	4	34	21
17	12	7	3	24	16
9	0	8	2	17	2
20	16	6	2	26	18
19	13	11	0	30	13
9	0	4	0	13	0
0	0	3	0	3	0
0	0	3	0	3	0

Një tjetër çështje me rëndësi që është në funksion të fuqizimit të transparencës dhe llogaridhënies së Kuvendit është rregullimi i kuadrit ligjor për lobim. Kjo çështje është paraparë edhe me Planin për Kuvend të Hapur 2023-2026 i lansuar nga Kuvendi në dhjetor të vitit 2022. Ndonëse në këtë drejtim ende nuk janë ndërmarrë konkret dhe përfaqësuesit e partive politike janë shprehur skeptik për rregullimin e kuadrit ligjor për lobimin.<sup>72</sup> Kështu, ndikimi i lobistëve në vendimarrje në Kuvend dhe jo vetëm mbetet ende i panjohur për publikun.<sup>73</sup>

72 Përmbledhje nga konferenca e KDI-së "A ka ardhur koha për ligjin për lobim?", me 14 dhjetor 2023 në: <https://kdi-kosova.org/aktivitetet/permbledhje-nga-konferenca-a-ka-ardhur-koha-per-ligjin-per-lobim/>

73 Shihni më shumë për çështjen e lobimit në Analizën e KDI-së "Është koha për Ligj për Lobim në Kosovë, e publikuar në qershor 2021 në: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2021/06/32-Policy-Paper-%C3%8Bsht%C3%AB-koha-p%C3%ABr-Ligj-p%C3%ABr-Lobim-n%C3%AB-Kosov%C3%AB-ALB-04.pdf>

|||||



# 7. Puna e Komisioneve Parlamentare

Komisionet gjatë sesionit vjeshtor kanë zhvilluar 131 mbledhje dhe 7 dëgjime, ndërsa në tërësi, për gjithë vitin 2023, komisionet kanë organizuar 358 mbledhje, numër në të cilin përfshihen edhe 17 dëgjime. Listes së komisioneve me aktivitet të lartë i'u prinë Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere me 39 mbledhje dhe 2 dëgjime; Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti 34 mbledhje dhe 5 dëgjime; Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale 31 mbledhje dhe 4 dëgjime publike; Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit me 30 mbledhje.

Përgjatë sesionit, komisionet kanë trajtuar afërsisht 30 projektligje, derisa kanë pritur 13 herë anëtarë të kabinetit qeveritar. Po ashtu, duhet të theksohet se një pjesë e aktivitetit të disa komisioneve, konsiston në vizita në teren dhe takime dhe takime zyrtare me përfaqësues ndërkombëtarë.

## Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere

Puna e Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere është mjaft voluminoze, jo vetëm nga fakti që është një nga katër komisionet e përhershme, por edhe për nga tema, meqë puna e tij ndërlidhet me buxhetin. Gjatë këtij sesioni, ky Komision ka organizuar 16 mbledhje dhe 2 Dëgjim Publike. Derisa, në sesioni e kaluar kishte organizuar 23 të tilla,<sup>74</sup> duke përmbledhur në tërësi 39 mbledhje dhe 2 dëgjime publike për vitin 2023.<sup>75</sup>

Çështje të cilat ky komision ka trajtuar rrokin buxhetin, administrimin e të dhënave sikurse raportet financiare të institucioneve që veprojnë në fusha sikurse Prokurimi, televizioni publik dhe medie, energjia, etj. Gjatë punës së këtij komisioni, janë shqyrtuar 18 ligje dhe janë votuar 8 raporte të përmbajtjeve financiare të institucioneve të ndryshme.

Në funksion të rritjes së llogaridhënies, mbikëqyrja, pranë komisionit zuri vend qendror në agjendën punuese. Për shembull, pranë këtij komisioni gjatë 5 raste ka raportuar ministri i Financave, Hekuran Murati. Temat ishin të ndryshme, duke filluar nga diskutimet lidhur me kompensimin për dëmet e shkaktuar nga vërshimet,<sup>76</sup> ndarjet buxhetore të vitit 2024, apo prezentimi i marrëveshjeve ndërkombëtare.<sup>77</sup> Ngjashëm, figura ekzekutive të institucioneve publike raportuan pranë këtij komisioni, derisa pasqyrat financiare po trajtoheshin.

## Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nuk zhvilloj një praktikë punë intensive, gjë për të cilën edhe përligj kritikant në drejtim të tij. Në sesionin vjeshtor, ai kishte mbajtur vetëm 7 mbledhje,<sup>78</sup> të cilave nëse i shtohen edhe 11 mbledhjet e mbajtura gjatë sesionit pranveror, shfaqin numrin 18 si numër të plotë të mbledhjeve të realizuara nga ky komision.

74 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 17; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

75 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 17-18; i qasshëm në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/39>

76 Informacionin e gjeni në uebin zyrtar të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-vazhdimi-i-mbledhjes-se-komisionit-per-bu-33565/>

77 Informacionin e gjeni në uebin zyrtar të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-buxhet-pune-dhe-34120/>

78 Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/40>



|||||

Gjatë punë parlamentare në sesionin vjeshtor ky Komision trajtoi 15 projektligje apo raporte të tyre. Po ashtu ky komision shqyrtoi edhe një Projek-Kod, atë të Doganor dhe Akcizave.

Mungesa e tetë deputetëve nga radhët e komuniteteve në këtë komision, përveç që ka shpeshherë vështirësuar krijimin e kuorumit të nevojshëm, ka privuar Komisionin prej një boshti të deputetëve të komuniteteve, prania e të cilëve është e domosdoshme, për të rritur legjitimitetin e punës së këtij komisioni.

Një vërejtje tjetër, ndoshta e përligjur nga mungesa e aktivitetit mbikëqyrës, shtrihet në funksionin mbikëqyrës të zbatueshmërisë së ligjeve, përgjegjësi që komisioni mund ta ushtroi në bazë të rregullt. Mungesa e një angazhimi të tillë, kundrejt Ligjeve që rrokin fushëveprimtarinë e Komisionit të Komuniteteve do të duhej të shërbente si kritikë që shpërfaq një mangësi elementare të Komisionit.

## **Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit**

Komisioni për Legjislacion, si nga komisionet e përhershme të Kuvendin, luan rol të rëndësishëm në procesin e ligjvënies – veçanërisht kur dihet se pjesa qendrore e agjendës legjislative të ekzekutivit rrokë reformimin e sistemit të drejtësisë. Në sesionin vjeshtor Komisioni për Legjislacion ka mbajtur 10 mbledhje, të cilat nëse mblidhen me 20 mbledhjet e sesionit paraprak,<sup>79</sup> numrin e plotë të mbledhjeve të mbajtura nga ky komision e ngrisin në 30 mbledhje.<sup>80</sup> Në njërin nga këto mbledhje, pjesëmarrëse ishte edhe ministrja, Albulena Haxhiu.<sup>81</sup>

Gjatë këtij vitit 2023, Komisioni është treguar mjaft aktiv në trajtimin e materialit legjislativ që kërkon trajtimin e tyre. Këtë sesion, në punimet e këtij Komisioni janë trajtuar 14 projektligje. Në sesionin e kaluar, ky komision ka trajtuar 35 projektligje apo raporte të tyre.<sup>82</sup> Duke vlerësuar dallimin në kohëgjatësi të sesioneve, në pikëpamje krahasimtare mund të pohohet që ky komision ka zhvilluar aktivitete të kënaqshme.

Ngjashëm ky Komision, përgjatë këtij sesioni, ka zhvilluar një punë mbikëqyrëse që duhet të vlerësohet lartë. Kësisoj, komisioni ka iniciuar proces të mbikëqyrjes për tre ligje: Ligjit Civil kundër shpifjes dhe fyerjes; Ligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit; dhe Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhurata.

## **Komisioni për Integrim Evropian**

Ngjashëm, edhe Komisioni Për Integrim Evropian, si një nga katër komisionet e përhershme, nuk pati nuk agjendë të ngarkuar, gjatë këtij sesioni. Ai zhvilloi vetëm 6 takime,<sup>83</sup> të cilat i bashkangjiten 12 të mbajtura në sesionin paraprak, duke dërguar numrin e mbledhje të mbajtura gjatë vitit 2023 në 18.<sup>84</sup>

Në këto seanca, ky Komision trajtoi tema të rëndësishme 10 projektligje. Duke vlerësuar nga pikëpamja e aktivitetit, mund të pohohet se nga të gjithë komisionet e përhershme, Komisioni për Integrim Evropian ishte aktiv.

79 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 17; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

80 Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/41>

81 Informacionin e gjeni në uebin zyrtar të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-legjislacion-33463/>

82 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit Kombëtar: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 17; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

83 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 19; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

84 Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/42>

|||||



## Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë

Angazhimi i Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë në punën parlamentare, gjatë sesionit vjeshtor, ka qenë pothuajse inekzistent. Megjithatë ky Komision ka mbajtur dhjetëra takime me përfaqësues dhe delegacione ndërkombëtare, në kuptim të aktivitetit të Komisionit, ai mbajti vetëm 5 mbledhje. Në tërësi, duke përfshirë edhe 7 mbledhjet e sesionit pranveror, Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë, ka mbajtur 12 mbledhje.<sup>85</sup>

Në njëren nga dy mbledhjet e mbajtura gjatë këtij sesioni, Komisioni ka pritur udhëheqësen e diplomacisë kosovovare, ministren Donika Gërvalla. Në këtë rast, Gërvalla, raportoi për ndarjen buxhetore, me referim tek fushëveprimtaria e Komisionit.<sup>86</sup>

Arsyet për pasivitetin e këtij komisioni janë të paqarta, porse fakti në vete është evident, që numra e mbledhjeve të organizuara nga ky Komision janë tejet të ulët dhe kjo praktikë kërkon përmirësim. Komisioni, në praktikën e përditshme të tij, nuk duhet të mjaftohet me takime të natyrës ceremoniale – kërkohet planifikim më përmbajtësor i punës së këtij komisioni.

## Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport

Komisioni funksional për Arsim, në sesionin vjeshtor, ka zhvilluar një agjendë të ngjeshur, duke mbajtur 10 mbledhje dhe 1 dëgjim publik. Në sesionin pranveror, ky komisioni kishte mbajtur 13 mbledhje dhe 2 dëgjime publike.<sup>87</sup> Rrjedhshëm, mund të pohohet, se me 26 mbledhje dhe 3 dëgjime publike,<sup>88</sup> puna e këtij Komisioni, gjatë këtij sesioni ka qenë intenzive.

Komisioni ka shqyrtuar 4 projektligje apo raporte të tyre, që rrokin fushëveprimtarinë e komisionit. Gjatë këtij sesioni, Komisioni për Arsim, ka trajtuar Projektligjin për të drejtat e autorit; PL për Rininë, PL për Art dhe Kulturë, për të cilin paraprakisht ka organizuar një dëgjim publik, Së bashku me aktivitetin funksional legjislativ, ka shqyrtuar edhe çështje tjera, për nga përmbajtja më teknokratike, sikurse Programin Kombëtar të Shkencës. Në aktivitetin e Komisionit për Arsim, janë përfshirë edhe dy ministra, Arbërie Nagavci dhe Hajrullah Ceku, të cilët morën pjesë në seancën informuese për ndarjet buxhetore.<sup>89</sup>

## Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti

Veprimtaria e Komisionit për Ekonomi, përfshinë një aktivitet parlamentar të gjerë dhe mjaft të rëndësishëm, që mund të ndikojë drejtpërdrejt jetën e qytetarëve. Komision ka mbajtur 14 mbledhje dhe një dëgjim publik gjatë këtij sesioni,<sup>90</sup> ndërsa në të kaluarin kishte mbajtur 24 mbledhje dhe 3 dëgjime publike.<sup>91</sup> Këto të dhëna e shpërfaqin aktivitetin e ngjeshur të këtij mekanizimit – 38 mbledhje dhe 4 dëgjime publike.

Gjatë këtij sesioni, ky Komisioni ka trajtuar përfundimisht 9 projektligje, në tërësi, me të gjithë raportet rreth tyre, kurse një tjetër vetëm në parim. Ndër trajtimet më të shquara ishin PL për Ratifikimin e Marrëveshjen Ndërkombëtare për Programin e Tregut të Vetëm, Projektligjet sikurse për Metrologji, për Investime të Qëndrueshme, raportin e Projektligjit për parqet industriale dhe teknologjike, trajtimi në parim i PL për promovimin e përdorimit të burimeve të ripërtërishe të energjisë.

Pranë këtij komisioni ka raportuar edhe ministrja Rozeta Hajdari.<sup>92</sup> Duhet të evidentohet se ky Komision, gjatë krizës së minatorëve të Trepçës, ka ndërmarrur disa veprime në drejtim jo vetëm të informimit në lidhje me situatën. Së pari,

85 Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/43>

86 Informacionin e gjeni në uebin zyrtar të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-pune-te-jashtme-33940/>

87 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 19; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

88 Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/44>

89 Informacionin e gjeni në uebin zyrtar të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-arsim-shkence-t-33871/>

90 Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/45>

91 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 19; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

92 Informacionin e gjeni në uebin zyrtar të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/deg-jiim-mbikeqyres-i-komisionit-per-ekonomi-34048/>





Komisioni priti në takimin përfaqësuesit të punëtorëve në grevë, më tutje duke e ftuar për raportim ministren e fushës, Artane Rizvanollin.<sup>93</sup> Ndërsa, ka organizuar edhe një dëgjim publik për PL për Fondin Sovran. Krejt në fund, duhet të theksohet se në aktivitetet e këtij komisioni është përfshirë puna mbikëqyrëse, do të thotë Komisioni për Ekonomi, gjatë këtij sesioni, filloi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për tregti me jashtë.

## **Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**

Rolin i Komisionit për Shëndetësi është jetik në trajtimin e agjendës legjislative, nga pikëpamja e fushëveprimtarisë së tij – posaçërisht në rastet e trajtimin të projektligjeve të ndjeshme për nga përmbajtja, sikurse ishte PL për Shëndeti Riprodhues dhe Fertilizim të Asistuar Mjekësor. Gjatë këtij sesioni, Komisioni për Shëndetësi, ka mbajtur 10 mbledhje dhe 2 dëgjime publike,<sup>94</sup> ndërsa në sesionin e kaluar Komisioni kishte mbajtur 22 mbledhje.<sup>95</sup> Kështu, aktiviteti vjetor i këtij Komisioni, kufizohet në 32 mbledhje dhe 2 dëgjime.

Ndonëse në vështrim të parë, numri i mbledhjeve gjatë këtij sesioni mund të krijojë përceptimin e një sesioni jo mjaftueshëm të kënaqshëm në punën e Komisionit për Shëndetësi – porse kur vlerësohet fakti se një pjesë e punës së Komisionit është përmbajtësisht legjislative, në funksion të draftimit të ligjeve të ndjeshme sikurse PL për Shëndeti Riprodhues dhe Fertilizim të Asistuar Mjekësor dhe PL për shërbime sociale dhe familjare. Për të dy projektligjet, Komisioni për Shëndetësi, përveç që ka themeluar grupe punuese, ka mbajtur edhe dëgjime publike. Këto projektligje, janë në mesin e 3 projektligjeve që ky komision ka votuar në javët e fundit të sesionit.

Ngjashëm, puna angazhimi në mbikëqyrje të zbatueshmërisë së ligjeve nga ana e Komisionit të Shëndetësisë është për tu vlerësuar pozitivisht. Komisioni, qysh në sesionin e parë filloi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Duhanin, aktivitet ky që vazhdoi edhe përgjatë pjesës së dytë të punës parlamentare.

## **Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim**

Gjatë sesioni vjeshtor, Komisioni për Mjedisin ka zhvilluar një agjendë jo shumë të ngjeshur, me 11 mbledhje të mbajtura, kurse në sesionin paraprak, ky Komision kishte mbajtur 15 mbledhje dhe 2 dëgjime publike.<sup>96</sup> Në totalin e tij, Komisioni ka organizuar 25 mbledhje dhe 2 dëgjime publike gjatë vitit 2023. Përmbajtësisht angazhimi i këtij Komisioni në procesin legjislativ gjatë sesionit vjeshtor, ka qenë i dukshëm – 8 projektligje, shqyrtimin e të cilave e përfunduan gjatë këtij sesioni.

Puna e këtij Komisioni është kufizuar në trajtimin e 8 PL, një nga të cilat marrëveshje ndërkombtare. Një vend të rëndësishëm, në pasqyrën e punës së këtij Komisioni, zë vend raportimi i ministrit të linjës, Liburn Aliu. Komisioni, në dy raste, e kishte ftuar për raportim pranë Komisionit, fillimisht një mbledhje të përgjithshme informuese dhe së dyti në prag të votimit të ndarjeve buxhetore të përcaktuar nga ekzekutivi, anëtarët e Komisionit kërkuan raportim që ndërlihet me buxhetimin. Ndërsa, pranë Komisionit për Mjedis, ka raportuar edhe ministri i Bujqësisë, Faton Peci.<sup>97</sup>

Në pikëpamje të mangësive, ky komision nuk ka ushtruar funksionin e mbikëqyrjes së zbatueshmërisë së ligjeve, edhe në rrethana kur shumë prej ligjeve që bien në fushëveprimtarinë e Komisionit, i'u mungon zbatimi adekuat. Prandaj, në kuptim të listimit të aktiviteteve ku Komisioni duhet të bëjë më mirë, mbikëqyrja zë vend – mbase në krye të renditjes. Më tepër se thirrja për të zbatuar drejtpërdrejt kompetencën e mbikëqyrjes, të përcaktuar nga Rregullorja, Komisioni duhet t'i përkushtohet punës së jashtme dhe monitoruese më tepër se komisionet tjera, meqë fushëveprimtaria rrokë problematikën e ambientit.

93 Informacionin e gjeni në uebin zyrtar të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-komisioni-per-ekonomi-industri-ndermarres-33742/>

94 Informacionin e gjeni në Platformën Votime, në vegëzën:

95 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënja në mes sfidash", f. 20; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

96 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënja në mes sfidash", f. 19-20; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

97 Informacionin e gjeni në uebin zyrtar të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-mjedis-ushqim-b-33994/>





## **Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale, Zhvillim Rajonal dhe Media**

Ndonëse ishte i pari që filloi punën e Komisioneve në sesionin vjeshtor, aktiviteti i këtij Komisioni, në javët në vazhdim ka shënuar rënie. Gjati këtij sesioni në tërësi komisioni ka mbajtur 6 mbledhje dhe një seancë degjimore,<sup>98</sup> ndërsa gjatë sesionit të gjatë pranveror kishte mbajtur 17 të tilla.<sup>99</sup> Në tërësi, gjatë vitit 2023, Kuvendi ka mbajtur 24 mbledhje dhe 1 seancë degjimore .

Gjatë këtyre seancave të sesionit vjeshtor, ky komision ka trajtuar pozitivisht Projektligje: PL për Zyrtarët Publik dhe ënë lëxim të parë] PL për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare. Ndërsa në periudhën e votimit të PL për ndarjet buxhetore, ky Komision ka organizuar një seancë degjimore, në lidhje me ndarjet buxhetore, ku të përfshira ishin institucionet dhe agjencionët, fushëveprimtaria e të cilave përshtatet me mandatin e komisionit.

Komisioni për Administratë Publike, po ashtu, çaloi në funksionin e mbikëqyrjes në tërësi – edhe në aktivitetet e ministrive të caktuara, veprimtaria e të cilave rrokë mandatin e këtij komisioni, edhe në mbikëqyrja e zbatueshmërisë së ligjeve. Kësisoj, një rubrikë e ndarë për të metat e këtij komisioni, duhet të paraqitet edhe performimi i dobët në mbikëqyrje gjatë sesionit vjeshtor. Çuditërisht, të njëjtën nuk mund të themi për sesionin pranveror, kur sadopak Komisioni kishte ndërmarrë veprimtari mbikëqyrëse si vlerësimi i raportëve të performimit të disa institucioneve publike, si: Radio-Televizionit të Kosovës, Komisionit të Pavarur të Medieve, Agjencisë për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore.

## **Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes**

Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, gjatë këtij sesioni, ka mbajtur 7 mbledhje dhe 1 degjim publike.<sup>100</sup> Ndërsa gjatë sesionit të kaluar, kishte zhvilluar 9 mbledhje.<sup>101</sup> Kështu, gjatë vitit 2023, ky komision ka zhvilluar gjithsej 15 mbledhje dhe 1 degjim publik.

Gjatë sesionit vjeshtor, në punimet e këtij mekanizimi janë votuar për kalimin 4 projektligje, kurse për Projektligjin e Agjencisë së Intelgjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është zhvilluar një degjim publik.<sup>102</sup> Po ashtu, për tu evidentuar është edhe raportimi i Komisionerës së Agjencinë për Informim dhe Privatësi, Krenare Sogojeva, në një mbledhje të rregullt të Komisionit.<sup>103</sup>

Duke kujtuar problemet e sigurisë që Kosova kaloi gjatë periudhës së sesionit vjeshtor, me sulmin në Banjskë në sfond të ngjarjeve, Komisioni në fjalë do të duhet të planifikonte një agjendë më të plotë apo të përpunuar – ku do të mund të përfshiheshin edhe aktivitete informimi edhe mbikëqyrëje kundrejt ekzekutivit, në lidhje me ngjarjet në Veri të Kosovës.

## **Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës, për Persona të Pagjetur dhe Peticione**

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, sesionit vjeshtor i'u është qasur me një agjendë ënë kuptimin e veprimtarisë legjislativë] mjaftë pasive, ai ka zhvilluar vetëm 6 mbledhje.<sup>104</sup> Ky Komision, sesionin e kaluar kishte zhvilluar 20 mbledhje,<sup>105</sup> duke ngritur numrin e përgjithshëm të mbledhjeve për vitin 2023, në gjithsej 26.

Në pikëpamje të përmbajtjes së agjendës legjislativë, ky komision ka shfaqur mungesë të materialeve legjislativë, rrjedhimisht edhe të trajtimit të tyre. Përgjatë këtyre mbledhjeve Komisioni ka shqyrtuar në dy raste peticione, në njërën

98 Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën:<https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/48>

99 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit Kombëtar: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 20; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

100 Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën:<https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/49>

101 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit Kombëtar: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 20; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

102 Informacionin e gjeni në uebin zyrtar të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/49>

103 Informacionin e gjeni në uebin zyrtar të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/mbledhja-e-komisionit-per-ceshtje-te-sigurise-34117/>

104 Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën:<https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/50>

105 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 21; i qasshëm në vegëzën:<https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>



nga këto, peticionin e punëtorëve të Radio-Televizionit të Kosovës.<sup>106</sup> Ngjashëm, ka zhvilluar takime me Panelin e Lirimit me Kusht dhe përfaqësuesit e institucionit të Avokatit të Popullit. Në përjashtim të PL për ndarjet buxhetore, asnjë iniciativë tjetër legjislative, nuk ka zënë vend në planifikimin legjislativ të këtij komisioni – fakt ky që duhet të kritikohet.

Ngjashëm, Komisioni nuk ka dhënë rezultatin e kërkuar në fushën e planifikimit dhe organizimit të punës mbikëqyrëse, me theks të veçantë mbikëqyrjes së zbatueshmërisë së ligjeve. Në këtë fushë, duke pasur në mendje, vështirësitë në zbatimin e ligjeve që bien në fushën e të drejtave të njeriut, Komisioni do të duhej të bënte më tepër. Porse, edhe praktika e takimeve dhe vizitave në institucione të ndryshme meriton të vlerësimin, duke njohur kufizimet dhe pamjaftueshmërimet e saj.

Përgjithshëm mund të pohohet, ky komision do të duhej të performonte më mirë në sesionin vjeshtor – dhe atë në funksionet elementare të ligjvënies dhe mbikëqyrjes.

## **Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave publike ka zhvilluar një agjendë që meriton vlerësime pozitive. Gjatë sesionit vjeshtor, ai ka zhvilluar 11 mbledhje,<sup>107</sup> derisa në sesionin paraprak kishte zhvilluar 19.<sup>108</sup> Në tërësi ky komision ka zhvilluar 29 mbledhje, në dy sesionet e vitit 2023. Prandaj mund të përfundohet se, puna parlamentare e këtij komisioni ishte e ekuilibruar, ndërmjet dy sesioneve.

Ngjashëm, për nga përmbajtja e punës, sesionin vjeshtor i këtij komisioni është i përafërt me paraprakun. Derisa në sesionin e kaluar ky komision kishte shqyrtuar 17 raporte, këtë sesion ka shqyrtuar 9 raporte auditimi apo pasqyra financiare të institucioneve të ndryshme, sikurse Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, Auditimit e Buxhetit, Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, Agjencionit Kosovar të Privatizimit, Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, Autoritetit për Komunikime Elektronike dhe Postare, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Në këtë komision, përgjatë shqyrtimit të ndarjeve buxhetore, në raportim ishte edhe ministri Elbert Krasniqi.<sup>109</sup> Aktiviteti mbikëqyrës, në kuptim të shqyrtimit të raporteve financiare ishte i bollshëm, ndërsa veprimtaria legjislative e komisionit kufizohet vetëm në trajtimin e Projektligjit që përcakton ndarjet buxhetore.

## **Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë**

Trendi i rënies së aktivitetit të Komisioneve është vërejtur edhe në punën e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Ky komision, përgjatë sesionit ka mbajtur 4 mbledhje.<sup>110</sup> Gjatë sesionit të kaluar, komisioni ka mbajtur 9 mbledhje,<sup>111</sup> duke përmbledhur numrin e mbledhjeve për tërë vitin në 12.

Ndër aktivitetet e shquara të këtij Komisioni, përgjatë këtij sesioni, ishte ftesa për raportim të udhëheqësit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, Petrit Ajetit. Ky raportim ndodhi në javën e parë të muajit tetor, pikërisht pas sulmit në Banjskë – deputetët janë informuar në një seancë të mbyllur, për të dhëna që ndërlidhen me ngjarjet në Veri të Kosovës.

Në kuptim të aktivitetit legjislativ, puna e këtij komisioni ka treguar një pamjaftueshmëri. Materiali legjislativ i trajtuar nga ky komision, kufizohet në Projektligjin për ndarjet buxhetore – veprim ky që është më tepër formal

<sup>106</sup> Informacionin e gjeni në uebin zyrtar të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-te-drejtat-e-nj-33775/>

<sup>107</sup> Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/51>

<sup>108</sup> Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 21; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

<sup>109</sup> Informacionin e gjeni në uebin zyrtar të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/mbledhja-e-komisionit-per-mbikëqyrje-te-financ-33508/>

<sup>110</sup> Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/52>

<sup>111</sup> Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit Kombëtar: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 21; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>



# PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Përgjithshëm, gjatë këtij viti në tërësi, Kuvendit ka shpërfaqur të gjitha mangësitë e zakonshme të punës, të cilat e kanë karakterizuar edhe vitet paraprake. **Për më tepër, lehtëzi, me trendin dhe faktet ekzistuese mund të pohohet që lëvizjet në këtë vit përveç që janë drejt përkeqësimit, ato në tregues të caktuar kanë shfaqur mangësi përtej të masës së zakonshme.**

Nëse lëvizim nga e përgjithshmja, tek e pjesshmja, duhet të pohohet se problemi i parë është mungesa e konsensusit apo kuptimit të përbashkët për punën që deputetët drejtojnë. Gjatë këtij viti, Kuvendi, ka demonstruar mungesë të madhe të konsensusit të domosdoshëm, si minimum që mundëson zhvillimin e punës parlamentare. Mungesa e trajtimit të një dokumenti sikurse është Projekt-Kodit Civil që përkufizon të drejtat civile të qytetarëve ilustron çarjen ndërmjet partive politike. Ngjashëm tek një numër marrëveshjesh ndërkombëtare, ka ekzistuar një refuzim pa ndonjë shpjegim ideologjik - për të ushqyer ndarjen ekzistuese. Këto situata duhet të kalohen, veçanërisht në trajtimin të materialeve që nuk rrokin politikën si veprimtari të përditshme.

Një nga problemet e evidentuara ka qenë interpretimi i Rregullores. **Në disa raste, interpretimi i Rregullores, duke injoruar një leximin preciz të librit të rregullave, vendimmarrjen brenda Kuvendit e ka zbritur në një proces të mbështetur në vullnete subjektive.** Në këtë raport, mbivendosja e vullneteve individuale, kanë krijuar precedente mosrespektuese, të cilët janë të rrezikshme për procedurën parlamentare në të ardhmën.

**Ndër mangësitë më të mëdha konsiston në planifikimi e punës parlamentare dhe përkitazi pritshmërive të vendosura, realizimin i agjendës.** Si rëndom, Kuvendi ka vepruar me agjendë të ngarkuar dhe të paplanifikuar, në pikëpamje të arritshmërisë mirë në pikëpamje - agjenda legjislave më tepër përfaqëson një projektion ideal, sesa një agjendë të hartuar, me kujdes e vëmendje për realizueshmërinë e saj. **Në 78 seanca të mbajtura janë miratuar 74 ligje. Në vështrim të parë mund të duket shtrirje në rregull, mirëpo duhet të theksohet se afërsisht 50 e ligjeve, janë miratuar në 7 seanca, ndërsa të tjerat në pjesën e mbetur.** Kjo shpërndarje disproporcionale, flet shumë për mungesën e trajtimit të shtrirë në seanca në një formë të përshtatshme për trajtim. Ngarkesën e deputetëve, në kuptim të ofrimit të hapësirës, e vë në sipërfaqje edhe fakti se deputetët, me këto numra të ngarkuar kanë trajtuar vetëm 52% të agjendës legjislative, me 28% e votuar plotësisht dhe 24% e mbetur në procedura të shqyrtimit.

Një nga funksionet ku Kuvendit ka shënuar rënie të theksuar është mbikëqyrja. Disa ngjarje forcojnë pretendimin se deputetëve, nga ana e partisë në pushtet i'u është vështirësuar ushtrimi i funksionit mbikëqyrës. Le të themi, pengesa për krijimin e Komisionit Hetimor për Rezervat Shtetërore, refuzimi për të ofruar përgjigje pyetjeve parlamentare të ardhura nga opozita, si dhe shpërfillja e ftesave për raportim, pretendim i deputetëve nga opozita, pranë komisioneve paraqesin hapa të mëdhënj në drejtime të kundërta, nga synimet kolektive tona, për arritjen e një rendi politik, brenda të cilit, institucionet i'a dalin të mirëmbajnë njëra-tjetrën në një mënyrë efikase.

Një ndër çështjet tipike që ndjekë Kuvendin është mungesa në lartësi të papranueshme nga ana e deputetëve, fenomen ky që rezulton në problemin tradicional të mungesës së kuorumit. **Edhe gjatë këtij viti, në praktikën parlamentare, kuorumi ka qenë një nga problemet thelbësore. Pa ekzagjeruar, shumica e seancave, arsye mbylljeje kanë pasur mungesën e kuorumit. Kjo situatë bëhet edhe më tepër problematike, kur kuptohet fakti se seancat të cilat janë mbyllur në mungesë të kuorumit, në bazë të evidencave të Kuvendit, kanë pasur mjaftueshëm kuorum të raportuar në dokumente, ku deputetët konfirmojnë praninë.**





|||||

**Ngjashëm, në pikëpamje të transparencës, Kuvendi nuk ka bërë asnjë përparim tu shquar. Gjatë një viti të plotë, nuk ka arritur të përfundoj pajisjen më mjetet që mundësojnë votimin elektronik, mungesë kjo që po e lëndon thellësisht punën parlamentare. Çalimi në këtë fushë shtrihet edhe në punën e komisioneve, raportimet pasuese të të cilave, mungojnë afërsisht në 41% të tyre, ndërsa 95% të mbledhjeve të publikuara i'u mungojnë transkriptat.**

Për fund, por jo për nga rëndësia, edhe në këtë sesioni sjellja e deputetëve vazhdoi të jetë nën-nivelin që kërkon funksioni. Gjatë këtij viti, tejkaloi kufirin e gjuhës jo-parlamentare dhe sjelljeve të papërshtatshme, duke prodhuar përlëshje fizike. Në formë të njëjtë, sikurse kjo praktikë, edhe reagimi i Kuvendit kundrejt kësaj problematike vazhdoi të mbetet i pandryshuar. Megjithëqë Rregullorja parasheh masa të ndryshme, në rrethan kur mungon vullneti për shqiptimin e tyre, ato mbesin të jenë masa të shkruara në letër, ekzistenca e të cilave vetiu nuk përmirëson asgjë nga puna parlamentare. Ndëshkimi për sjellje joparlamentare paraqet një realitet të pahasur në Kuvendin e Kosovës – në funksion të përmirësimit të gjendjes, deputetët duhet të njoftohen më përgjegjësitë që bartin edhe nëpërmjet gjobës apo ndëshkimit.

Rrjedhshëm, kundrejt mangësive të shpërfaqura në punën e Kuvendit, KDI ofron rekomandimet e mëposhtme:

- **KONSENSUSI POLITIK:** Për çështje si miratimi i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe ndryshimet kushtetuese si te rasti i amendamenteve për Vetingun, partitë politike duhet të ndërtojnë konsensus politik për të shtyrë përpara çështje që prekin drejtpërdrejt interesin qytetar.
- **RESPEKTIMI I RREGULLORES:** Procedurat në Kuvend, në tërësinë e tyre, duhet të drejtohen sipas përcaktimeve të Rregullores. Të gjithë aktorët brendaparlamentarë, duhet të tregojnë vlerësim për Rregulloren – posaçërisht kjo vërejtje duhet të drejtohet tek Kryetari i Kuvendit dhe mënyra se si ai ka interpretuar librin e rregullave. Rregullorja drejton vendimarrjen, jo vullnetet e subjekteve individuale.
- **PLANIFIKIM I AGJENDAVE TË ARRITSHME:** Kuvendi duhet të ndryshojë qasjen me të cilën trajton planifikimin e agjendës. Ndryshim nga mënyra ekzistuese, nënkupton hartimin e agjendave të arritshme për trajtim, shtrirjen e seancave në kalendar në një formë më të përshtatshme për të mundësuar trajtimin e kërkuar nga deputetët. Kësisoj, duhet të mbahen më shumë seanca, me më pak ngarkesë të rëndeve të ditës dhe të shtrira më mirë në kalendar. Si dhe krijimi i një kalendari mujor.
- **MBIKËQYRJA E FEFKTIVE:** Kuvendi duhet të angazhohet për mbikëqyrje efikase duke shfrytëzuar mekanizmat kontrollues parlamentar. Në këtë drejtim, deputetët e Kuvendit duhet të parashirojnë më shumë pyetje parlamentare ndaj antarëve të Qeverisë dhe të garantojnë llogaridhënie të ekzekutivit përmes raportimeve në seanca dhe komisione.
- **PJESËMARRJE TË RREGULLT NË PUNIMET E KUVENDIT:** Si hap fillestar i zgjidhjes së problemit të kuorumit, Kuvendi duhet të sigurojë saktësi ndërmjet të dhënave të pranisë fizike dhe pranisë së deputetëve, në të vërtetë. Papajtueshmëria në këto të dhëna është shqetësuese – seancat e dështuara për mungesën e kuorumit, në dokumentet e prezentuara kanë kuorumin e mjaftueshëm për të zhvilluar punimet. Derisa, problemi i mungesave, duhet të trajtohet vetiu, nëpërmjet praktikave vetëdijësuese për deputetët dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së vazhdueshme në punën parlamentare.
- **RITJE E TRANSPARENCËS:** Kuvendi duhet të veprojë në drejtimin të plotësisimit të mangësive që ka shfaqur, në çështjen e transparencës. Duke filluar prej rikthimit të votimit elektronik, deri tek plotësimi i përcaktimeve të Rregullores, sikurse publikimet pasuese të dokumenteve të mbledhjeve. Në vështrim të parë, ngecja e Kuvendit në këtë drejtim mund të duket sipërfaqësore, mirëpo hapat që duhet të bëhen janë shumë përmbajtësor. Gjithashtu Kuvendi duhet të draftojë sa më parë legjisalcionin për rregullimin e lobimit në Kuvend.

|||||



- **MIRATIM DHE RESPEKTIM TË PËRPIKTË TË KODIT TË SJELLJES:** Një fushë ku Kuvendi duhet të veprojë shpejtë, është sjellja e deputetëve. Në këtë pikë, Kuvendi, duhet të interpretojë Rregulloren në mënyrë më strikte, veçanërisht në masat e ndërmarrura karrshi sjelljeve të papërshtatshme dhe fjalorin jo-parlamentar. Së bashku me të, Kuvendi duhet të miratojë hartojë Kodin e Sjelljes dhe të kujdeset që ky dokument të saktësojë rrethana ndëshkuese dhe masa të mirëfillta të ndëshkimit.





